



**UNIVERSITETI I TIRANE**  
**FAKULTETI I GJUHEVE TE HUAJA**  
**DEPARTAMENTI I ANGLISHTES**

**PROGRAMET E LENDEVE TE CIKLIT TE PARE TE STUDIMEVE,**  
**VITI AKADEMIK 2016-2019**

**FUSHA: GJUHE ANGLEZE**  
**DREJTIMI: GJUHE ANGLEZE**

**Morfologji e Gjuhës B**

<b>Moduli:</b>	Morfologji e Gjuhës B
<b>Cikli:</b>	Bachelor
<b>Fusha e formimit</b>	Gjuhë Angleze
<b>Kursi kurrikular</b>	Gjuhë Angleze
<b>Kursi:</b>	I
<b>Viti/Semestri:</b>	I/1
<b>ECTS:</b>	4 kredite
<b>Nr. Leksioneve:</b>	20 orë
<b>Nr. Seminareve:</b>	20 orë
<b>Pedagogu/(ët) e lëndës:</b>	Dr. Etleva Kondi, Dr. Hatixhe Sejdini

### **PËRSHKRIMI I MODULIT**

Lënda “Morfologji e gjuhës angleze” trajton formën e fjalës dhe pjesët e ligjëratës. Programi i lëndës mbulon pjesët e ligjëratës si emri, folja, mbiemri, ndajfolja dhe parafjala si dhe strukturat kryesore të tyre. Një vëmendje e vecantë u kushtohet dhe problemeve kryesore që hasen me këto pjesë të ligjëratës dhe strukturave të tyre si p.sh. problemet me kohët e foljeve apo dhe parafjalët që ndjekin foljet, emrat apo mbiemrat.

Nëpërmjet trajtimit të problemeve themelore, duke përdorur si metodë edhe përqasjen midis formave e përdorimit të tyre në të dyja gjuhët (angleze e shqipe) programi synon të ndihmojë në formimin e dijeve të shëndosha tek studentët.

### **Objektivat e kursit:**

Ky kurs synon të:

- bëjë studentët më të ndërgjegjshëm në përdorimin e saktë të formave gramatikore të gjuhës angleze
- të mundësojë konsolidimin e njohurive gramatikore të fituara e t'i lartësojë ato nga pikëpamja cilësore,
- të aftësojë studentët për të bërë përgjithësime teorike të domosdoshme për një specialist në këtë fushë.

### **Rezultatet e pritshme:**

Pasi studenti njihet dhe praktikon çështjet e trajtuar në modulën e morfologjisë, kjo nëpërmjet teroisë së trajtuar gjatë leksioneve dhe seminareve të cilat meshojnë në zbatimin dhe praktikimin

e çështjeve gramatikore të trajtuara, atij i kërkohet që të demonstrojë informacionin e përftuar nëpërmjet përmbushjes së detyrave që i ngarkohen nga pedagogët.

Studenti në fund të kësaj lënde duhet të::

- kuptojë natyrën e veçantë të morfologjisë
- të jetë i aftë të aplikojë njohuritë e përftuara
- të njohë llojet e ndryshme të fjalëformimit në gjuhën angleze dhe strukturat gramatikore të pjesëve të ligjëratës
- të shpjegojë dhe përdorë saktë strukturat përkatëse të pjesëve të ligjëratës të trajtuara

### **Metoda didaktike:**

Zhvillimi i lëndës kryhet nëpërmjet Leksioneve teorike dhe seminareve. Studenti duhet të frekuentojë leksionet dhe seminarët si dhe të jetë aktiv gjatë vitit akademik. Vlerësimi i tij bëhet nëpërmjet pyetjeve të ndryshme mbi teorinë dhe ushtrime praktike. Ai duhet të shlyejë detyrimet e lëndës përpara se të marrë pjesë në provimin përfundimtar.

### **VLERËSIMI**

Test 1 (Emri)	20%
Test 2 (Folja)	30%
Pjesmarrja	10 %
Provimi përfundimtar	40 %

### **LITERATURA E DETYRUESHME**

- Geoffrey Leech, Jan Svartvik, A communicative Grammar of English Collins Cobuild English Grammar
- Mark Foley & Diane Hall, Longman Advanced Learners' Grammar
- Rodney Hudleston, Geoffrey Pullum, A student's introduction to English grammar, Cambridge University Press, 2009.
- Sydney Greenbaum, Randolph Quirk A Student's Grammar of the English Language
- Richard Side and Guy Wellman, Grammar and Vocabulary for CAE and CPE
- Cikël leksionesh përgatitur nga titullaret e lëndës bazuar në bibliografinë e detyrueshme dhe atë të rekomandur

### **LITERATURA E REKOMANDUAR**

- Geoffrey Broughton, Penguin English Grammar A-Z Exercises for Advanced Students
- Geoffrey Leech, Meaning and the English Verb
- Martin Parrot, Grammar for English language teachers, Cambridge University Press 2000
- Michael Lewis, The English Verb Language Teaching Publications 1986
- Michael Swan, Practical English Usage, Oxford University Press 1997
- Ronald Carter, Michael McCarthy, Cambridge Grammar of English A comprehensive Guide

## **Analizë teksti e Gjuhës B (1)**

Programi i lëndës	
<b>Moduli:</b>	Analizë teksti e Gjuhës B (1)
<b>Cikli:</b>	Bachelor
<b>Fusha e formimit</b>	Gjuhë Angleze
<b>Kursi kurrikular</b>	Gjuhë Angleze
<b>Kursi:</b>	I
<b>Viti/Semestri:</b>	I/1
<b>ECTS:</b>	6 kredite (=60 orë)
<b>Nr. Leksioneve:</b>	
<b>Nr. Seminareve:</b>	6 kredite (=60 orë)
<b>Pedagogu/(ët) e lëndës:</b>	Dr. Daniela Hasa, Dr. Etleva Kondi, Dr. Pandora Teta, Dr. Alketa Pema, Dr. Irena Pata, Dr. Ogerta Koruti, Dr. Kristina Sheperi

## PËRSHKRIMI I MODULIT

Kursi synon t'i aftësojë studentët në përmirësimin e vazhdueshëm të shprehive bazë gjuhësore, përkatësisht të folurit, të shkruarit, dëgjimin dhe leximin. Kjo arrihet përmes aktiviteteve, teksteve autentike dhe temave të larmishme në qendër të të cilave është përsosmëria e aftësisë së të shprehurit qartë e rrjedhshëm në gjuhën angleze.

Nëpërmjet teksteve të ndryshme të ligjërimit më shkrim dhe me gojë synohet pasurimi i fjalorit në anglisht dhe zotërimi i strukturave gramatikore për të zhvilluar aftësitë shprehëse të studentëve. Gjithashtu studentët pritet të përmisojnë dhe pasurojnë strategjitë e tyre dhe autonominë e të nxënit nëpërmjet pjesmarrjes së tyre në veprimtari mësimore ndëraktive.

### Objektivat e kursit:

Ky kurs synon:

- të zhvillojë aftësitë e të lexuarit të tipeve të ndryshme të teksteve si letra, reklama, artikuj gazete, pjesë nga letersia, pjesë të shkëputura nga libra shkencorë, informacione të ndryshme nga broshura etj.
- thellojë aftësitë e tyre për t'u përgjigjur pyetjeve specifike që kërkojnë një lexim të vëmendshëm dhe kuptimin e informacionit të nënkuptuar.
- zhvillojë dhe thellojë aftësitë e të shkruarit dhe kryesisht të një letre familjare, të një aplikimi, artikulli, raporti për një veprimtari të dhënë, histori të shkurtra, hartime përshkruesë, raport mbi një pjesë leximi etj.
- zhvillojë vetëdijen e studentëve për gjuhën duke punuar për identifikimin dhe korrigjimin e gabimeve, transformimin e fjalive, teksteve me vende boshe .
- pasurojë fjalorin aktiv të studentëve bazuar mbi mësimin e fjalëve kyce, fjalëformimin, familjet e fjalëve,
- zhvillojë aftësitë e dëgjimit të tipeve të ndryshme të teksteve si mesazhe telefonike, leksione, lajme, biseda, reklama, pjesë të shkëputura nga drama të ndryshme, me qëllim nxjerrjen e informacionit ose kryerjes së detyrave të ndryshme në lidhje me pjesën e dhënë
- zhvillojë aftësitë e të folurit në mënyrë të rrjedhshme, duke përdorur një gjuhë të pastër dhe në përputhje me rregullat gramatikore, për të qënë të aftë të

përshkruajnë, të diskutojnë, të bëjnë hipoteza të ndryshme, të argumentojnë dhe të japin opinionet e tyre për problemet që diskutojnë.

- thellojë aftësitë e të punuarit në menyrë të pavarur duke ju dhënë dhe thëlluar strategji të të nxënit (mësuarit).

### **Rezultatet e pritshme:**

Në fund të kursit studentët do jenë të aftë të:

- lexojnë tekste të zhanreve të ndryshme dhe të kuptojnë idetë kryesore të tyre,
- kuptojnë detajet, nënkuptimet, informacionin specifik, organizimin dhe strukturën e teksteve të ndryshme të përdorura në mësim,
- komunikojë më folës vendas në mënyrë të kuptueshme, të kthejë përgjigje për pyetjet e drejtuara dhe të japë informacion për jetën e tij, interesat, shkollën dhe familjen,
- prodhojnë tekste të qarta dhe të detajuara për një shumëllojshmëri temash si tipe të ndryshme letrash, artikuj, esse, përmbledhje tekstesh dhe histori, duke përdorur strukturën dhe gramatikën e duhur, si dhe të përdorë drejt shenjat e pikësimit si dhe drejtshkrimin
- shpjegojnë me shkrim dhe me gojë pikëpamjet e tyre për përparsitë dhe disavantazhet e zgjedhjeve të ndryshme
- të tregojnë se kuptojnë tekste të ndryshme si monologje, leksione, intervista dhe biseda etj.
- të kuptojnë pikat kryesore, opinionet, informacionin specifik, qëndrimet dhe emocionet e bashkëbiseduesve.

### **VLERËSIMI**

- Përgatitja e performanca vjetore: 10%
- Test 2x15 30%
- Shkrime 2x5 10%
- Prezantim 20%
- Testi përfundimtar: 30%

### **LITERATURA E DETYRUESHME**

- Jan Bell, Amanda Thomas, *Gold first certificate. New edition. Coursebook*, 2015
- Sally Burgess, Jacky Newbrook, *Gold First, Exam Maximiser*, 2015
- Clementine Annabell, Rawdon Wyatt, *Gold First, Teacher's Book*, 2015

### **LITERATURA E REKOMANDUAR**

Thomas, B J, *Advanced Vocabulary and Idiom*, Nelson, 1991

Lynn Lundquist, *Spoken English Learned Quickly*, 2008

<http://iteslj.org/questions/>

[www.newsdirectory.com](http://www.newsdirectory.com)

[www.theworldpress.com](http://www.theworldpress.com)

[www.FreeEnglishNow.com](http://www.FreeEnglishNow.com)

<http://www.flo-joe.com/fce/students/tests/tsindex.htm>

[http://www.examenglish.com/FCE/Use\\_of\\_English.htm](http://www.examenglish.com/FCE/Use_of_English.htm)

### **Gjuhë C (1)**

<b>Programi i lëndës</b>	
<b>Moduli:</b>	Gjuhë C (1)
<b>Cikli:</b>	I pare
<b>Fusha e formimit</b>	
<b>Kursi kurrikular</b>	Bachelor
<b>Kursi:</b>	Viti i parë
<b>Viti/Semestri:</b>	i pare
<b>ETCS:</b>	4 kredite
<b>Nr. Leksioneve:</b>	
<b>Nr. Seminareve:</b>	40 ore
<b>Pedagogu/(ët) e lëndës:</b>	

## **PËRSHKRIMI I MODULIT**

Kjo lënde synon t'u ofrojë studentëve një bazë njohurise të gjuhës angleze për ta përdorur atë si mjet komunikimi në jetën e përditshme dhe në ambiente të ndryshme ku mund të paraqitet nevoja e komunikimit me këtë gjuhë.

### **Objektivat e kursit:**

Në fund të kursit studentët duhet të jenë në gjendje:

- Të pyesin dhe të përgjigjen në gjuhën angleze për tema të ndryshme të jetës së përditshme.
- Të komunikojnë me folës të tjerë të gjuhës angleze pa pasur probleme të të kuptuarit.
- Të diskutojnë për tema të ndryshme që ofrohen në libër por edhe nga vetë studentët.
- Të përdorin konceptet mbi mesatare të gjuhës angleze në dokumente zyrtare, në letra jozyrtare, në mesazhe elektronike dhe në histori të ndryshme.
- Të krijojnë dhe të shkruajnë histori duke përdorur fjalorin përkatës dhe të mëparshëm të marrë gjatë këtyre javëve mësimore.
- Të lexojnë dhe të kuptojnë një tekst te regjistrave te ndryshme dhe më pas të jenë të aftë ta përpunojnë atë.

### **Rezultatet e pritshme:**

- Të bëjë të mundur komunikim sa më të lirshëm.
- Studentët të pajisen me njohuri mbi mesatare gramatikore.
- Të mundësojë pjesëmarrje të studentëve në diskutime të plota dhe gjithëpërfshirëse.
- Të ndihmojë studentët të shkruajnë dhe të lexojnë rrjedhshëm në gjuhën angleze.

### **Metoda didaktike**

Per realizim e kesaj lende do te perdoret libri i studentit dhe libri i ushtrimeve, detyra te ndryshme, prezantime dhe pune ne grupe.

## VLERËSIMI

- Test i ndërmjetëm 1 = 20%
- Test i ndërmjetëm 2 = 20%
- Pjesëmarrja (përfshin përgjigjet në klasë dhe detyrat me shkrim të kërkuara gjatë semestrit) = 30%
- Provimi përfundimtar = 30%

## BIBLIOGRAFI E DETYRUESHME

Harris M, Mower D, Sikorzysnka A. New Opportunities – Pre- intermediate, Student’s book, Longman

Harris M, Mower D, Sikorzysnka A , New Opportunities Pre-Intermediate Language Powerbook, Longman

## BIBLIOGRAFI E REKOMANDUAR

Ky kurs bazohet në metodën e përmendur më lart, por studentëve do t’u kërkohet të këshillohen me libra, revista dhe internetin në mënyrë që të marrin njohuri shtesë mbi fushat dhe konceptet e dhëna në libër.

## FONETIKË DHE FONOLOGJI E GJUHËS ANGLEZE

Programi i lëndës	
<b>Moduli:</b>	FONETIKË DHE FONOLOGJI E GJUHËS ANGLEZE
<b>Cikli:</b>	I
<b>Fusha e formimit</b>	GJUHË ANGLEZE
<b>Kursi kurrikular</b>	BACHELOR
<b>Kursi:</b>	Viti I (Gjuhë angleze)
<b>Viti/Semestri:</b>	I/I
<b>ECTS:</b>	4 Kredite - (= 40 orë)
<b>Nr. Leksioneve:</b>	15 orë
<b>Nr. Seminareve:</b>	25 orë
<b>Pedagogu/(ët) e lëndës:</b>	Dr. Rudina Xhillari; Msc. Anxhela Bardhyli, Doktorante; Dr. Erjon Agolli

## PËRSHKRIMI I MODULIT

Kjo lëndë synon të ofrojë njohuri teorike e praktike në lidhje me fonetikën dhe fonologjinë e gjuhës angleze. Leksionet së bashku me seancat laboratorike ndërthuren në mënyrë të tillë që studentët të marrin njohuri teorike mbiçështje të ndryshme të fonetikës e fonologjisë, të tingujve,

fjalëve e fjalive në gjuhën angleze dhe t'i praktikojnë këto në orët e seminareve dhe seancave laboratorike. Në fund studenti bën njëpunim kërkimor shkencor ku përqasen dhe bëhen krahasime ndërmjet gjuhës shqipe dhe angleze sipas temave të leksioneve e seminareve.

### **Objektivat e kursit:**

Kursi synon:

1. T'i orientojë studentët shqiptarë të fitojnë një shqiptim sa më të mirë të tingujve të anglishtes;
2. T'u mësojë studentëve parimet bazë të fonetikës dhe të fonologjisë;
3. T'u mësojë studentëve terminologjinë bazë të fonetikës dhe të fonologjisë;
4. T'u mësojë transkriptimin dhe alfabetin fonetik të gjuhës angleze;
5. T'u mësojë tiparet prozodike të ligjëritimit në gjuhën angleze si: theksi, ritmi, intonacioni etj. duke i krahasuar me elementët përkatës në gjuhën shqipe;
6. T'u ngulitë ato tipare fonetike që janë tipike për gjuhën angleze;
7. T'u mësojë dallimet në shqiptim ndërmjet varianteve të ndryshme të gjuhës angleze dhe amerikane;
8. T'u ofrojë studentëve njohuri për tu përfshirë në punë kërkimore në fushën e fonetikës dhe fonologjisë.

### **Rezultatet e pritshme:**

1. studenti përmirëson shqiptimin e tingujve, zotëron tiparet e vecantitë e theksit, ritmit, intonacionit të gjuhës angleze;
2. studenti mëson të transkribojë saktë në gjuhën angleze;
3. studenti mëson dhe përvetëson dallimet në shqiptim ndërmjet anglishtes britanike dhe amerikane;
4. studenti mëson tiparet prozodike të ligjëritimit në gjuhën angleze nën këndvështrimin përqasës e krahasues me gjuhën shqipe;
5. studenti bën punë kërkimore duke përdorur metoda përqasëse krahasuese.

### **Metoda didaktike**

- Leksione
- Teksti bazë
- Seminare në laborator
- Ushtrime
- PPT

### **VLERËSIMI**

- Provimi gjysmëfinal: 20%
- Projekt: 30%
- Frekuentimi dhe pjesëmarrja 10%
- Provimi përfundimtar 40%

### **BIBLIOGRAFI E DETYRUESHME**

- Cikël leksionesh i përgatitur nga titullari i lëndës
- Roach Peter, (2000) English Phonetics and Phonology, A practical Course, Cambridge University Press

- Dodi Anastas, (2004) Fonetika dhe Fonologjia e gjuhës shqipe, Akademia e Shkencave e Shqipërisë
- Bowler Bill & Cunningham Sarah, (1991) Headway Upper-intermediate Pronunciation, Oxford University Pres

## BIBLIOGRAFI E REKOMANDUAR

- Burleigh, P., A Manual of English Phonetics and Phonology, Gunter Narr Verlag, 2011
- Cruttenden, A., 1997, Intonation, Cambridge University Press
- Goga, Behushi, A Course in English Phonetics
- Conorthy, J. , (1989) Teaching English Pronunciation, Longman Handbooks for Language Teacher
- Cook, V.J., (2008) Active Intonation, Longman
- Nolan, Francis, (2008), The Handbook of English Linguistics
- Wakelin, Martyn F. (1972). English dialects: An introduction (revised edition).
- London: Athlone

### Hyrje në Letërsi 1

Programi i lëndës	
<b>Moduli:</b>	Hyrje në Letërsi 1
<b>Cikli:</b>	Bachelor
<b>Fusha e formimit</b>	Letrare
<b>Kursi kurrikular</b>	Gjuhë Angleze
<b>Kursi:</b>	I
<b>Viti/Semestri:</b>	2016-2017/i parë
<b>ECTS:</b>	6 kredite
<b>Nr. Leksioneve:</b>	15
<b>Nr. Seminareve:</b>	45
<b>Pedagogu/(ët) e lëndës:</b>	Dr. Albert Sheqi, Msc. Brunilda Kondi, Doktorante, Dr. Manjola Nasi, Dr. Sidita Hoxhiq, Msc. Blerina Zaimi

## PËRSHKRIMI I MODULIT

Lënda Hyrje në Letërsi 1 zhvillohet në semestrin e parë të vitit të parë dhe prezanton studentët me gjinitë letrare. Ajo përqendrohet te proza dhe paraqet elementet kryesore të analizimit të saj nisur nga modele analizimi të tregimeve të trajtuara gjatë semestrit.

### Objektivat e kursit:

Lënda Hyrje në Letërsi 1 synon:

- Të njohë studentët me aspektet kryesore teorike të prozës artistike (duke përfshirë të gjitha nënlojet e saj si; fabula, përralla, tregimi, novela dhe romani, me fokus kryesor te tregimi dhe novela;



- T'u japë studentëve njohuri teorike dhe praktike të dobishme për të interpretuar, analizuar, vlerësuar dhe shkruar një analizë të plotë të një vepre letrare;
- T'u japë studentëve një njohuri të përgjithshme për disa prozatorë të spikatur amerikanë dhe anglezë;
- T'u ofrojë mjedisin praktik për analizën estetike dhe letrare të disa tregimeve dhe romaneve të mirënjohur në gjuhën angleze;
- Të përmirësojë nivelin gjuhësor të studentëve nëpërmjet analizës stilistikore të tregimeve dhe novelave origjinale në gjuhën angleze.

### **Rezultatet e pritshme:**

Me përfundimin me sukses të këtij kursi studentët do të jenë në gjendje të argumentojnë pse një tekst është teks letrar. Ata do të jenë gjithashtu në gjendje të lexojnë nga afër tregime e novela e të analizojnë ato duke patur parasysh gjithë elementet letrare si: struktura, rrëfimi, personazhet, simbolet, etj. Mbi këto njohuri, ata do të jenë gjithashtu të aftë të bëjnë interpretime shkrimesh në prozë nga këndvështrime të ndryshme teorish letrare si strukturalizmi, feminizmi, analiza psikologjike, etj.

### **Metoda didaktike**

Orët e leksioneve janë të ndërtuara mbi prezantime në Poërpoint dhe diskutime interaktive me studentët, mbi bazën e parimit që njohuritë e reja vendoset mbi ato që studentët dinë tashmë.

### **VLERËSIMI**

- Provimi gjysmëfinal: 20%
- Projekt: 30%
- Frekuentimi dhe pjesëmarrja 10%
- Provimi përfundimtar 40%

### **BIBLIOGRAFI E DETYRUESHME**

- Kennedy, X.J., Literature: an introduction to fiction, poetry, and drama, fourth edition; Little, Brown and Company, Boston Toronto, 1987.

### **BIBLIOGRAFI E REKOMANDUAR**

- Albcarian. R, Klotz. M; Literature, The Human Experience, St. Martins Press, 1994.
- Ashley, Leonard, R.N. The History of the Short Story, Simon and Schuster, 1968.
- Bain, E. Carl, The Norton Introduction to Literature, W.W. Norton & Company, Sixth Edition, 1995.
- Cassill, R.V. The Norton Anthology of Short Fiction, W.W. Norton & Company, 1978.
- Gordon, Kuehner; Fiction, an introduction to the short story, NTC 1999.
- Richter, H. David; The Borzoi Book of Short Fiction, McGraw Hill. Inc. 1983.

### **Hyrje në Letërsi 2**

### **Programi i lëndës**

<b>Moduli:</b>	Hyrje në Letërsi 2
<b>Cikli:</b>	Bachelor
<b>Fusha e formimit</b>	Gjuhe Angleze
<b>Kursi kurrikular</b>	Gjuhë Angleze
<b>Kursi:</b>	I
<b>Viti/Semestri:</b>	2016, Semestri II
<b>ECTS:</b>	6
<b>Nr. Leksioneve:</b>	15
<b>Nr. Seminareve:</b>	45
<b>Pedagogu/(ët) e lëndës:</b>	Prof.Asoc. Dr. Adriana Dervishi, Dr. Esmeralda Subashi, Dr. Manjola Nasi, Prof.Asoc. Dr. Adriana Dervishi, Dr. Kristina Sheperi

## PËRSHKRIMI I MODULIT

### Objektivat e kursit:

1. Ky kurs synon t'i prezantojë studentët me parimet dhe njohuritë themelore të poezisë dhe dramës dhe t'i thellojë ata në këto fusha.
2. Të paraqesë nënloje të ndryshme të poezive dhe dramës, për t'u krijuar studentëve koncepte sa më të qarta në lidhje me këto zhanre të letërsisë.
3. T'u japë atyre njohuri teorike dhe praktike të dobishme për të interpretuar, analizuar, vlerësuar dhe shkruar një analizë të plotë të një veprë letrare.
4. Të aftësojë studentët në analizimin praktik të elementëve teorike nëpërmjet diskutimit në klasë të një numri të konsiderueshëm poezish dhe dramash.
5. T'i nxisë studentët që të mprehin mendimin e tyre kritik dhe individual. Vepra letrare, me poliseminë e saj, është e hapur ndaj interpretimeve të ndryshme që mund të bëjnë studentët, të cilët nxiten që të shprehin mendimin e tyre të argumentuar.

### Rezultatet e pritshme

Në fund të kursit studentët duhet:

1. të kenë njohje të mirë të elementeve bazë teorike të poezisë dhe dramës.
2. të jenë më të aftë të analizojnë, kuptojnë dhe përjetojnë një poezi, dramë, komedi apo tragjedi në të gjithë elementet e tyre të formës dhe përmbajtjes.
3. të kenë përmirësuar nivelin e përvetësimit të gjuhës dhe pasurimit të saj me terma poetike dhe letrare.
4. të mprehin mendimin e tyre kritik dhe individual.

**Metoda didaktike:** Leksione dhe seminare.

### VLERËSIMI

- Provimi gjysmëfinal: 20%
- Projekt: 30%
- Frekuentimi dhe pjesëmarrja 10%
- Provimi përfundimtar 40%

## BIBLIOGRAFI E DETYRUESHME

- Cikël leksionesh nga titullari i lëndës
- *Literature: An Introduction to Fiction, Poetry and Drama*, 4<sup>th</sup> edition, X.J. Kennedy, Little, Brown and Company, Boston and Toronto, 1987. (I disponueshëm në bibliotekën e Departamentit të Gjuhës Angleze)

## BIBLIOGRAFI E REKOMANDUAR

- *The Penguin Dictionary of Literary Terms and Literary Theory*, 3rd edition, J.A.Cuddon, Penguin Books, London, 1992. (I disponueshëm në bibliotekën e Departamentit të Gjuhës Angleze).
- *Encyclopaedia of Literature and Criticism*, editors Martin Coyle, Peter Garside, Malcolm Kelsall, John Peck, Detroit, New York: Routledge, 1991. (I disponueshëm në bibliotekën e Departamentit të Gjuhës Angleze).
- *The Norton Anthology of English Literature*, M.H.Abrams, General Editor, New York: W.W.Norton & Company: 1996. (I disponueshëm në bibliotekën e Departamentit të Gjuhës Angleze).
- *The Norton Anthology of English Literature, Volume 1*, Fifth Edition, Editor M.H.Abrams, New York, London: W.W. Norton: 1986. (I disponueshëm në bibliotekën e Departamentit të Gjuhës Angleze).
- *A History of English Literature*, Revised edition, Emile Legouis, Louis Cazamian, London: J.M.Dent and Sons LTD. (I disponueshëm në bibliotekën e Departamentit të Gjuhës Angleze).
- <http://www.americanpoems.com/>
- <http://www.poets.com/>

### Analizë teksti e Gjuhës B (2)

Programi i lëndës	
<b>Moduli:</b>	Analizë teksti e Gjuhës B (2)
<b>Cikli:</b>	Bachelor
<b>Fusha e formimit</b>	Gjuhë Angleze
<b>Kursi kurrikular</b>	Gjuhë Angleze
<b>Kursi:</b>	I
<b>Viti/Semestri:</b>	II/2
<b>ECTS:</b>	6 kredite (=60 orë)
<b>Nr. Leksioneve:</b>	
<b>Nr. Seminareve:</b>	6 kredite (=60 orë)
<b>Pedagogu/(ët) e lëndës:</b>	Prof.Dr. Elida Tabaku, Prof.Dr. Petraq Buka, Dr. Etleva Kondi, Dr. Irena Pata, Dr. Rudina Vrioni, Dr. Erjon Agolli

## PËRSHKRIMI I MODULIT

Kursi Analize teksti e Gjuhës B (2) është vazhdim i kursit Analizë teksti e Gjuhës B (1) dhe synon të zhvillojë më tej aftësitë komunikuese të studentëve në gjuhën angleze duke vazhduar punën e bërë në semestrin e parë. Krahas zhvillimit të katër aftësitë gjuhësore si dëgjim, të folur, lexim dhe shkrim i kushtohet rëndësi zhvillimit të aftësisë së studentëve për leximin e një shumëllojshmërie tekstesh si dhe zgjerimit dhe pasurimit ta fjalorit të tyre për të qënë të aftë të përdorin tekste akademike dhe të gjuhës së përditshme.

## **Objektivat e kursit**

Ky kurs synon:

- të thellojë dhe konsolidojë aftësitë e të lexuarit në gjuhën e huaj të teksteve të tipeve të ndryshme.
- të zhvillojë aftësitë e nxjerrjes së kuptimit nëpërmjet hamendjes, parashikimit, nxjerrjes së ideve kryesore ,scanning and skimming.
- të zhvillojë aftësitë e të dëgjuarit duke e lidhur atë me detyrë specifike dhe me paraqitjen e materialeve autentike.
- të zhvillojë aftësitë e të shkruarit nëpërmjet organizimit të punës parapërgatitore, planifikimit dhe korrigjimit të punës paraprake përpara përfundimit të detyrës si dhe organizimit të korrigjimeve gjuhësore.
- të zhvillojë aftësitë e të folurit nëpërmjet përfshirjes së studentëve në diskutime lidhur me temat e trajtuara duke i inkurajuar studentët të punojnë në grupe ose në role-play.
- të pasurojë dhe përforcojë fjalorin duke i mëshuar përdorimit të sinonimeve, antonimeve, phrasal verbs, fjalëformimit.
- të përmisojë aftësitë e studentëve për të mësuar në mënyrë të pavarur duke i nxitur të punojnë me fjalorin dhe duke i inkurajuar për lexime të pavarura.

## **Rezultatet e pritshme**

Në fund të kursit studentët do jenë të aftë të:

- lexojnë tekste të zhanreve të ndryshme dhe të kuptojnë idetë kryesore të tyre.
- kuptojnë detajet, nënkuptimet, informacionin specifik, organizimin dhe strukturën e teksteve të ndryshme të përdorura në mësim.
- komunikojnë më folës vendas në mënyrë të kuptueshme, të kthejnë përgjigje për pyetjet e drejtuara dhe të japin informacion për jetën e tyre, interesat, shkollën dhe familjen.
- prodhojnë tekste të qarta dhe të detajuara për një shumëllojshmëri temash si tipe të ndryshme letrash, artikuj, ese, përmbledhje tekstesh dhe histori, duke përdorur strukturën dhe gramatikën e duhur , të përdorin drejt shenjat e pikësimit si dhe drejtshkrimin.
- shpjegojnë me shkrim dhe me gojë pikëpamjet e tyre duke shpjeguar përparsitë dhe disavantazhet e këtyre pikëpamjeve të ndryshme.
- tregojnë se kuptojnë tekste të ndryshme si monologje, leksione, intervista, biseda etj.
- kuptojnë pikat kryesore, opinionet, informacionin specifik, qëndrimet dhe emocionet e bashkëbiseduesve.

## **VLERËSIMI**

- Përgatitja e performanca vjetore: 10%
- Test 2x15 30%

- Shkrime 2x5 10%
- Prezantim 20%
- Testi përfundimtar: 30%

## LITERATURA E DETYRUESHME

- Jan Bell, Amanda Thomas, *Gold first certificate. New edition. Coursebook*, 2015
- Sally Burgess, Jacky Newbrook, *Gold First, Exam Maximiser*, 2015
- Clementine Annabell, Rawdon Wyatt, *Gold First, Teacher's Book*, 2015

## LITERATURA E REKOMANDUAR

- Thomas, B J, *Advanced Vocabulary and Idiom*, Nelson, 1991
- Lynn Lundquist, *Spoken English Learned Quickly*, 2008
- <http://iteslj.org/questions/>
- [www.newsdirectory.com](http://www.newsdirectory.com)
- [www.theworldpress.com](http://www.theworldpress.com)
- [www.FreeEnglishNow.com](http://www.FreeEnglishNow.com)
- <http://www.flo-joe.com/fce/students/tests/tsindex.htm>
- [http://www.examenglish.com/FCE/Use\\_of\\_English.htm](http://www.examenglish.com/FCE/Use_of_English.htm)
- Gold First Certificate ,
- <http://www.flo-joe.com/fce/students/tests/tsindex.htm>
- [http://www.examenglish.com/FCE/Use\\_of\\_English.htm](http://www.examenglish.com/FCE/Use_of_English.htm)

### Shkrim Akademik

Programi i lëndës	
<b>Moduli:</b>	Shkrim Akademik
<b>Cikli:</b>	Bachelor
<b>Fusha e formimit:</b>	Gjuhësi
<b>Kursi kurrikular:</b>	Gjuhë Angleze
<b>Kursi:</b>	Viti I
<b>Viti/Semestri:</b>	2016-2017, semestri i dytë
<b>ECTS:</b>	4
<b>Nr. Leksioneve:</b>	0
<b>Nr. Seminareve:</b>	40
<b>Pedagogu/(ët) e lëndës:</b>	Prof.Asoc.Dr. Leonard Danglli, Dr. Miranda Veliqaj, Dr. Kristina Ajazi, Dr. Rovena Vora, Dr. Alketa Pema

## PËRSHKRIMI I MODULIT

Ky kurs ofron:

- Një hyrje gjithëpërfshirëse në Shkrimin Akademik.
- Të kuptuarit e procesit të shkruarit.

- Përbërësit kryesorë të të shkruarit.
- Llojet kryesore të eseve, paragrafëve etj.
- Ushtrimin e studentëve në llojet e ndryshme të shkrimit.

### **Objektivat e kursit dhe rezultatet e pritshme**

Në fund të këtij kursi, studentët duhet të përmbushin objektivat e mëposhtëm:

- Ta konsiderojnë të shkruarin si proces me disa faza.
- Të jenë në gjendje të marrin parasush elementet e ndryshme të të shkruarit si lexuesit, tonin, qëllimin etj.
- Të jenë në gjendje të lexojnë në mënyrë kritike.
- Të jenë në gjendje të shkruajnë një paragraf të ndërtuar mirë.
- Të jenë në gjendje të shkruajnë një paragraf koherent.
- Të jenë në gjendje të shkruajnë një fjali temë të përshtatshme.
- Të jenë në gjendje të shkruajnë një ese të organizuar mirë.
- Të jenë në gjendje të shkruajnë një fjali tezë të përshtatshme.
- Të jenë në gjendje të japin argumente gjatë procesit të të shkruarit.
- Të jenë në gjendje të parafrzojnë, përmbledhin etj.
- Të jenë të vetëdijshëm për problemet kryesore gjuhësore dhe t'i shmangin ato gjatë të shkruarit.

### **Metoda didaktike**

Gjatë zhvillimit të këtij kursi do të përdoren një sërë metodash dhe strategji të mësimdhënies të cilat synojnë rritjen e efikasitetit të procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Orët e mësimit do të kenë në qendër studentin dhe aktivizimi i tij do të realizohet edhe nëpërmjet punës në grup, në çift, apo zhvillimit të projekteve të përbashkëta. Synohet rritja e rolit ndërveprues të studentit nëpërmjet vlerësimit të njëri-tjetrit apo trajtimit të çështjeve të ndryshme në formën e diskutimit. Do të vihen gjithashtu në zbatim elemente të metodave analitike, përshkruese, krahasuese, etj.

### **VLERËSIMI**

- 30% provimi në mes të semestrit
- 20% detyra me shkrim
- 10% pjesëmarrja aktive në orën e mësimit
- 40% provimi përfundimtar

### **BIBLIOGRAFI E DETYRUESHME**

Zemach, E. Dorothy, Rumisek, A. Lisa (2005) Academic Writing: from paragraph to essay, Macmillan.

### **BIBLIOGRAFI E REKOMANDUAR**

- Oshima, Alice and Ann Hogue. (1999) Writing Academic English, 3 rd Ed. White Plains, NY: Longman.

- Gibaldi, Joseph, MLA handbook for writers of research papers, The modern language association of America, 1995.
- Zemach, Dorothy; Rumisek, Lisa. MacMillan Publishers, 2013

## Hyrje në Gjuhësi

Programi i lëndës	
<b>Moduli:</b>	<b>Hyrje në Gjuhësi</b>
<b>Cikli:</b>	Bachelor
<b>Fusha e formimit</b>	Gjuhë Angleze
<b>Kursi kurrikular</b>	Gjuhë Angleze
<b>Kursi:</b>	I (A, B, C, D, E, F, G, H)
<b>Viti/Semestri:</b>	I/2
<b>ECTS:</b>	4 kredite (= 40 orë)
<b>Nr. Leksioneve:</b>	2 Kredite - (= 20 orë);
<b>Nr. Seminareve:</b>	2 Kredite - (= 20 orë).
<b>Pedagogu/(ët) e lëndës:</b>	Dr. Leonora Lumezi, Dr. Daniela Hasa, Dr. Hatixhe Sejdini

### PËRSHKRIMI I MODULIT

Kjo lëndëi pajis studentët me disa njohur hyrëse në teorinë dhe metodologjinë e gjuhësisë, e cila është studimi shkencor i gjuhës. Ata mësojnë rreth degëve kryesore të kësaj shkence, përkatësisht rreth fonetikës, fonologjisë, morfologjisë, sintaksës, semantikës, pragmatikës, sociolinguistës dhe historisë së zhvillimit të shkencës së gjuhësisë.

Studentët njihen edhe me zbatimin e kësaj shkence në praktikë por duke eksploruar natyrën komplekse të gjuhës njerëzore nga perspektiva biologjikepsikologjike, kulturore dhe sociale. Një vëmendje e veçantë i kushtohet nocionit të gjuhës si një sistem i strukturuar forme dhe kuptimi si edhe përdorimit të saj. Njohuritë e gjuhës mësohen si një element i njohjes njerëzore dhe se si ato ndikojnë edhe në fusha të tjera të lidhura ngushtë me gjuhësinë, siç janë për shembull marrëdhëniet ndërmjet gjuhës dhe mësimdhënies, gjuhës dhe përkthimit e aspekte të tjera të gjuhësisë së aplikuar.

### Objektivat e kursit:

Objektivat kryesore të kësaj lënde janë:

- të njohë studentët me konceptet kryesore për gjashtë fushat kryesore të gjuhësisë, si për shembull fonetikën, fonologjinë, morfologjinë, sintaksën, semantikën, pragmatikën dhe ndërveprimin ndërmjet tyre
- t'u japë studentëve njohuri të përgjithshme për mënyrat dhe sistemet e komunikimit dhe t'i njohë ata me karakteristikat e gjuhës së folur dhe shkruar edhe avantazhet e disavantazhet e secilës prej këtyre formave komunikimi;
- të ndërgjegjësojë studentët për shumëllojshmërinë e sistemeve gjuhësore por në të njëjtën kohë edhe për ngjashmëritë e tyre themelore
- të njohë studentët me disa nga parimet dhe mekanizmat bazë të funksionimit të gjuhës se si kuptimi i fjalëve arrihet përmes strukturës së tyre të ndërlikuar të brendshme dhe të njohë mekanizmat të cilat mund ta ndryshojnë atë.

## Rezultatet e pritshme:

Në fund të kursit studentët do të jenë të aftë të:

- të pajisen me disa mjete dhe teknika për të analizuar dhe kuptuar tëdhënat gjuhësore
- të kuptojnë dhe në këtë mënyrë të përvetësojnë më mirë funksionet komunikative tëgjuhësisë dhe parimet kryesore që janë përgjegjëse si për formimin e fjalëve, fjalive ashtu edhe për interpretimin e tekstit
- zbatojnë në praktikë analizën gjuhësore të fjalës, fjalisë dhe tekstit, si edhe të bëjnë dallimin ndërmjet strukturave përgjegjëse për dykuptimësinë
- të kenë një njohje më të mirë se si dhe pse gjuha ndryshon në kohë, ndërmjet folësve të saj, si edhe për familjet e ndryshme të gjuhëve.

## Metoda didaktike

Programi realizohet përmes leksioneve, seminareve, ushtrimeve, prezantimeve, punës në grup dhe detyrave të kursit dhe provimit përfundimtar.

## VLERËSIMI

- Provimi gjysmëfinal: 2x 15 = 30%
- Projekt(Punë në grup): 20%
- Frekuentimi dhe pjesëmarrja 10%
- Provimi përfundimtar 40%

## BIBLIOGRAFIE DETYRUESHME

1. Language Files: Materials for an Introduction to Language and Linguistics, 11th Edition Ohio State University Press 2011, Columbus USA
2. William O’Grady, Michael Dobrovolsky, Francis Katamba (1997),*Contemporary Linguistics (An Introduction)*Longman, UK
3. Akmajian, R.A. Demers, Ann K. Farmer, R. M. Harnish, *Linguistics*, Third edition, 1990, MIT Cambridge, London, England

## BIBLIOGRAFI E REKOMANDUAR

1. McKay, Sandra Lee, Sau-Ling Cynthia Wong, *Language diversity: problem or resource?* New York: Newbury House Publishers
2. Victoria Fromkin, Robert Rodman, Nina Hyams, (2014)*Introduction to Language*, Tenth Edition, Wadsworth, Cengage Learning

## Gjuhe C (2)

Programi i lëndës	
Moduli:	Gjuhë C (2)
Cikli:	I pare
Fusha e formimit	



<b>Kursi kurrikular</b>	Bachelor
<b>Kursi:</b>	Viti i parë
<b>Viti/Semestri:</b>	i dytë
<b>ETCS:</b>	4 kredite
<b>Nr. Leksioneve:</b> <b>Nr. Seminareve:</b>	40 ore
<b>Pedagogu/(ët) e lëndës:</b>	

## PËRSHKRIMI I MODULIT

Kjo lënde synon t'u ofrojë studentëve një bazë njohurise të gjuhës angleze për ta përdorur atë si mjet komunikimi në jetën e përditshme dhe në ambiente të ndryshme ku mund të paraqitet nevoja e komunikimit me këtë gjuhë.

### Objektivat e kursit:

Në fund të kursit studentët duhet të jenë në gjendje:

- Të pyesin dhe të përgjigjen në gjuhën angleze për tema të ndryshme të jetës së përditshme.
- Të komunikojnë me folës të tjerë të gjuhës angleze pa pasur probleme të të kuptuarit.
- Të diskutojnë për tema të ndryshme që ofrohen në libër por edhe nga vetë studentët.
- Të përdorin konceptet mbi mesatare të gjuhës angleze në dokumente zyrtare, në letra jozyrtare, në mesazhe elektronike dhe në histori të ndryshme.
- Të krijojnë dhe të shkruajnë histori duke përdorur fjalorin përkatës dhe të mëparshëm të marrë gjatë këtyre javëve mësimore.
- Të lexojnë dhe të kuptojnë një tekst te regjistrave te ndryshme dhe më pas të jenë të aftë ta përpunojnë atë.

### Rezultatet e pritshme:

- Të bëjë të mundur komunikim sa më të lirshëm.
- Studentët të pajisen me njohuri mbi mesatare gramatikore.
- Të mundësojë pjesëmarrje të studentëve në diskutime të plota dhe gjithëpërfshirëse.
- Të ndihmojë studentët të shkruajnë dhe të lexojnë rrjedhshëm në gjuhën angleze.

### Metoda didaktike

Per realizim e kesaj lende do te perdoret libri i studentit dhe libri i ushtrimeve, detyra te ndryshme, prezantime dhe pune ne grupe.

### VLERËSIMI

- Test i ndërmjetëm 1 = 20%
- Test i ndërmjetëm 2 = 20%

- c. Pjesëmarrja (përfshin përgjigjet në klasë dhe detyrat me shkrim të kërkuara gjatë semestrit) = 30%
- d. Provimi përfundimtar = 30%

## BIBLIOGRAFI E DETYRUESHME

Harris M, Mower D, Sikorzysnka A. New Opportunities – Pre- intermediate, Student’s book, Longman

Harris M, Mower D, Sikorzysnka A , New Opportunities Pre-Intermediate Language Powerbook, Longman

## BIBLIOGRAFI E REKOMANDUAR

Ky kurs bazohet në metodën e përmendur më lart, por studentëve do t’u kërkohet të këshillohen me libra, revista dhe internetin në mënyrë që të marrin njohuri shtesë mbi fushat dhe konceptet e dhëna në libër.

### Shprehi Studimi e Parashtrimi

Programi i lëndës	
<b>Moduli:</b>	Shprehi Studimi e Parashtrimi
<b>Cikli:</b>	Bachelor
<b>Fusha e formimit</b>	Disipline plotesuese
<b>Kursi kurrikular</b>	Cikli I
<b>Kursi:</b>	I
<b>Viti/Semestri:</b>	Viti 1, Semestri 1
<b>ECTS:</b>	4 kredite
<b>Nr. Leksioneve:</b>	0 leksione
<b>Nr. Seminareve:</b>	40 ore
<b>Pedagogu/(ët) e lëndës:</b>	Prof. Asoc.Dr. Uk Buçpapaj, Dr. Alketa Pema, Dr. Manjola Nasi, Msc. Anxhela Bardhyli, Doktorante, Msc. Ermal Çomo

## PËRSHKRIMI I MODULIT

### Objektivat e kursit:

Lënda " Shprehi Studimi e Parashtrimi" synon të zhvillojë tek studentet aftësinë për të mesuar dhe studiuar në mënyrë të efektshme dhe te pavarur në gjuhën angleze dhe jo vetem.

Ky kurs ka në qendër të vëmendjes udhëzime teorike dhe praktikë konkrete përsa i përket të menduarit kritik, vlerësimit të situatave, përcaktimit të afateve të studimit, të kuptuarit e llojeve të leximit, ushtrimit të kujtesës dhe strategjive për të arritur rezultate të kënaqshme në provime.

### **Rezultatet e pritshme:**

Nëpërmjet ushtrimeve të ndryshme praktike, leximit analitik dhe kritik të teksteve të përzgjedhura nga autorë të ndryshëm, studentët do të studiojnë stile të ndryshme të shprehurit si dhe kategoritë dhe metodat e leximeve që do t'i ndihmojnë të zhvillojnë një të kuptuar kritik, menaxhim të mirë të kohës dhe do të gjejnë mënyrat për t'u motivuar gjatë të nxënimit.

### **Metoda didaktike**

Lenda përfshin seminare, detyra praktike dhe teste me shkrim dhe goje gjate modulit. Studentët duhet të ndjekin kursin rregullisht dhe të përmbushin detyrat e caktuara në grup ose individualisht. Në fund të modulit zhvillohet provim me shkrim.

## **VLERËSIMI**

- Provimi gjysmëfinal: 20%
- Projekt: 30%
- Frekuentimi dhe pjesëmarrja 10%
- Provimi përfundimtar 40%

## **BIBLIOGRAFI E DETYRUESHME**

Wallace, Michael J., Study Skills in English, Cambridge University Press.

Donald, Sydney, Kneale. Pauline, "Study Skills for Language Students", a practical guide, Oxford University Press, 2001.

Seale, Barbara "Writing efficiently", A step by step composition course, Prentice hall, Inc. Englewood Cliffs, 1998.

## **BIBLIOGRAFI E REKOMANDUAR**

- Fry, Eduard, Reading faster, Cambridge University Press.
- Buzan, Tony. Use your head, BBC Publications London 1974.
- <http://www.nutsandboltsguide.com>
- <http://www.uwm.edu>
- <http://web.uvic.ca/wguide/>

## **Sintaksë e gjuhës B**

<b>Programi i lëndës</b>	
<b>Moduli:</b>	Sintaksë e gjuhës B
<b>Cikli:</b>	I parë
<b>Fusha e formimit</b>	Gjuhësi
<b>Kursi kurrikular</b>	Bachelor
<b>Kursi:</b>	II
<b>Viti/Semestri:</b>	II/I
<b>ECTS:</b>	4 kredite
<b>Nr. Leksioneve:</b>	20

<b>Nr. Seminareve:</b>	20
<b>Pedagogu/(ët) e lëndës:</b>	Dr. Leonora Lumezi, Dr. Violeta Shaba

## **PËRSHKRIMI I MODULIT**

### **Objektivat e kursit:**

Sintaksa studion strukturën e fjalisë; ajo merret me parimet që diktojnë kombinimin e fjalëve për të formuar njësi më të mëdha gjuhësore (ndër të cilat fjalia është e një rëndësie thelbësore), si dhe me veçoritë e këtyre njësive.

Kursi i sintaksës angleze synon të ndihmojë studentët që të kuptojnë se gjuha është një sistem dhe struktura e saj gramatikore është elementi i saj më i fortë. Nga pikëpamja akademike, ai synon t'i pajisë studentët me njohuritë e duhura në mënyrë që të ndërjegjësohen lidhur me përdorimin e formave të sakta gjuhësore përmes eksplorimit dhe analizës; ta shohin gramatikën të tillë që u mundëson të kuptojnë lidhjen e formës me kuptimin dhe të kuptimit me funksionin në kontekst; të konsolidojnë dhe të zhvillojnë më tej njohuritë e përfutuara gramatikore; të zgjerojnë, përmirësojnë dhe zotërojnë strukturën e gjuhës, si edhe t'i aftësojë studentët të bëjnë përgjithësimet teorike të nevojshme për një specialist gjuhe.

Duke ofruar një trajtim të qartë të çështjeve gramatikore të cilat paraqesin probleme për studentin e huaj do të bëjë të mundur që studenti të përftojë njohuri të shëndosha të gramatikës e cila nuk trajton vetëm format e fjalëve, por edhe funksionet e tyre në fjali.

### **Rezultatet e pritshme:**

Me përfundimin me sukses të këtij kursi, studentët do të jenë në gjendje:

- të përkufizojnë dhe shpjegojnë konceptet bazë në analizën sintaksore (duke iu referuar veçanërisht strukturës së gjymtyrëve të fjalisë, strukturës së frazës, funksioneve gramatikore, llojeve të fjalisë);
- të zbatojnë njohuritë e tyre të morfosintaksës në analizimin e të dhënave;
- të krahasojnë anglishten e sotme standarde me gjuhë të tjera (duke iu referuar sidomos veçorive morfosintaksore);
- të demonstrojnë një qasje kritike ndaj zhvillimit të një gramatike përshkruese;
- të ngrenë hipoteza;
- të përdorin të dhëna për të provuar hipotezat;
- të demonstrojnë aftësi kërkimore.

### **Metoda didaktike:**

Leksione e seminare, projekte në grup, punë e pavarur

### **VLERËSIMI**

- Provimi gjysmëfinal: 2×20%
- Projekt: 10%
- Frekuentimi dhe pjesëmarrja: 10%
- Provimi përfundimtar: 40%

## BIBLIOGRAFI E DETYRUESHME

- A Student's Grammar of the English Language (Sydney Greenbaum, Randolph Quirk)
- Cambridge Grammar of English. A comprehensive Guide (Ronald Carter, Michael McCarthy)
- Downing A., & Locke P, (2006): English Grammar, a university course, Routledge
- Longman Advanced Learners' Grammar (Mark Foley & Diane Hall)

## BIBLIOGRAFI E REKOMANDUAR

- Collins Cobuild English Grammar
- Grammar for English language teachers (Cambridge University Press 2000, Martin Parrott)
- Practical English Usage (Oxford University Press (1997), Michael Swan)
- Oxford Guide to English Grammar (Oxford University Press 1994, John Eastwood)
- Grammar and Vocabulary for CAE and CPE (Richard Side and Guy Wellman)

### Historia e Mbretërisë së Bashkuar

Programi i lëndës	
<b>Lënda:</b>	Historia e Mbretërisë së Bashkuar
<b>Cikli:</b>	Bachelor
<b>Kursi:</b>	Viti II (Gjuhë angleze)
<b>Semestri:</b>	I (i parë)
<b>ECTS:</b>	4 Kredite - (= 40 orë);
<b>Nr. Leksioneve:</b>	2 Kredite - (= 20 orë);
<b>Nr. Seminareve:</b>	2 Kredite - (= 20 orë).
<b>Pedagogu/(ët) e lëndës:</b>	Prof. Dr. Petraq Buka, Msc. Anxhela Bardhyli, Doktorante

### Pershkrimi i lendes

Kjo lende pershkruan ne menyre kronologjike historine e qyteterimit te Britanise qe nga pushtimi romak(v. 43 E.J.) deri ne kurorezimin e mbretereshes Elisabeta II ne 1952. Lenda i njeh studentet me periudhat perkatese te sundimit te monarkeve ne Britani, me zhvillimet me te rendesishme politike dhe shoqerore si dhe me konfliktet e brendshme e luftrat e vashdushme te popullit anglez gjate shekujve. Gjithashtu, lenda flet per lufterat e shumta te popullit anglez ndaj pushtuesve te huaj si dhe per perpjekjet e shumta te shoqerise britanike per zhvillimin e demokracise nepermjet parlamentarizmit, gje qe çoi ne vendosjen e monarkise kushtetuese dhe forcimin e rolit te parlamentit. Gjithashtu studentet njihen me zhvillimin e institucioneve kryesore politike te vendit ne forme kronologjike si dhe me zhvillimin ekonomik te Britanise qe arriti kulmin me 'revolucionin industrial' ne shekullin e 19te.

### Objektivat e lendes:

Lenda synon:

- t'i njohë studentet me historinë politike, shoqërore dhe ekonomike të mbretërisë britanike
- të nxisë studentet dëshirën për studimin e kësaj lende nëpërmjet seminarëve
- të nxisë studentet të studiojnë lëndën në mënyrë logjike duke evituar studimin mekanik të saj
- të nxisë studentet të bëjnë dallimin midis monarkive britanike si dhe midis periudhave të ndryshme të historisë britanike
- të nxisë studentet mendimin kritik duke gjetur pika të përbashkëta midis ngjarjeve të caktuara të historisë së Britanisë dhe saj të Shqipërisë

### **Rezultatet e pritshme:**

Në fund të kursit studentet të kenë një formim të përgjithshëm për etapën dhe zhvillimet kryesore të historisë së popullit anglez

### **Metoda**

Leksionet do zhvillohen nëpërmjet teknikës së Power Point, duke shoqëruar ligjërimin me video ilustruese për ta bërë sa më të qartë dhe të kuptueshëm leksionin nga studentet.

### **Vlerësimi**

Frekuentimi 10%

Seminaret 20%

Testi i ndërmjetëm 20%

Provimi përfundimtar 50%

### **LITERATURA E REKOMANDUAR**

- History of England - Prof Petraq Buka (titullari i lëndës)
- The Making of England (55BC – 1399) Warren Hollister
- This Realm of England (1399 – 1688) Lacey Baldwin Smith
- Age of Aristocracy 1688 – 1830) William B. Willcox
- Britain Yesterday and Today (1830 to the present) Walter L. Arnstein
- The Oxford History of Britain /Keneth O. Morgan
- A Peoples's History of Britain /A.L.Morton
- A short History of England/ Simon Jenkins
- 20th century Britain /W Robson

#### **Leksikologji e Gjuhës Angleze**

<b>Programi i lëndës</b>	
<b>Moduli:</b>	<b>Leksikologji e Gjuhës Angleze</b>
<b>Cikli:</b>	Bachelor
<b>Fusha e formimit</b>	Gjuhë Angleze
<b>Kursi kurrikular</b>	Gjuhë Angleze
<b>Kursi:</b>	II
<b>Viti/Semestri:</b>	II/I
<b>ECTS:</b>	4 Kredite - (= 40 orë);

<b>Nr. Leksioneve:</b>	2 Kredite - (= 20 orë);
<b>Nr. Seminareve:</b>	2 Kredite - (= 20 orë).
<b>Pedagogu/(ët) e lëndës:</b>	Prof.Asoc. Dr. Leonard Danglli, Dr. Fatma Shijaku, Dr. Irena Pata, Prof. Dr. Ilo Stefanllari

## **PËRSHKRIMI I MODULIT**

Moduli “Leksikologji e Gjuhës Angleze” është pjesë e programit trevjeçar Bachelor të formimit të studentëve të gjuhës angleze në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja në Universitetin e Tiranës. Kjo lëndë synon trajtimin e njohurive bazë në disiplinën gjuhësore të leksikologjisë së gjuhës angleze duke analizuar çështje të rëndësishme të semantikës, leksikografisë, etimologjisë së gjuhës angleze, dukuri të leksikologjisë, aspekte stilistikore, si dhe ndërtimin dhe zotërimin e një fjalësi dinamik për studentët nëpërmjet punimit të ushtrimeve të shumta dhe konsultimit të fjalorëve të ndryshëm.

### **Objektivat e kursit:**

Objektivat kryesore të kësaj lënde janë:

- T’u japë studentëve njohuritë kryesore në lidhje me dukuritë kryesore leksikologjike të gjuhës angleze, si dhe të ndihmojë në aftësimin e tyre për përdorimin e drejtë të mjeteve leksikore të shprehjes.
- T’u paraqesë dhe nxisë tek studentët domosdoshmërinë e përdorimit të fjalorëve dhe teksteve të ndryshme për t’i përgatitur ata drejt një pune të pavarur në lidhje me zgjerimin dhe përvetësimin e shtresave të ndryshme të leksikut.

### **Rezultatet e pritshme:**

Në fund të kursit studentët do të jenë të aftë të:

- kenë një njohje të mirë të çështjeve baze teorike të disiplinës gjuhësore të leksikologjisë së gjuhës angleze;
- kenë një njohje të mirë të aspekteve semantike, etimologjike, leksikografike dhe stilistikore të fjalësit të gjuhës angleze;
- kenë një përvetësim të mirë të shtresave të ndryshme të leksikut dhe përdorim të drejtë të mjeteve leksikore;
- përdorin në mënyrë sa më të efektshme fjalorë dhe tekste të ndryshëm për një njohje më të gjerë dhe të thellë të leksikut dhe sfidave që ai paraqet.

### **Metoda didaktike**

Programi realizohet përmes leksioneve, seminareve, ushtrimeve, prezantimeve, punës në grup, provimeve gjysmëfinale dhe provimit përfundimtar.

### **VLERËSIMI**

- Provimi në mes të semestrit: 20%
- Detyra/projekt: 20%
- Pjesëmarrja aktive në orën e mësimi 20%
- Provimi përfundimtar 40%

### **BIBLIOGRAFI E DETYRUESHME**

1. Stefanllari, Ilo “A course in English Lexicology”, Tiranë: “Geer”, 2011.
2. Lipka, Leonhard: “English Lexicology”, Gunter Narr Verlag Tubingen, Germany, 2002

## BIBLIOGRAFI E REKOMANDUAR

1. Jackson, Howard dhe Ze Amvela, Ettiene “Words, Meaning and Vocabulary” (An introduction to modern English lexicology”), Athaneum Press, Gateshead, Tyne and Wear, Great Britain, 2007
2. Cowie, A.P. “Semantics”, Oxford University Press, 2009
3. Thomai, Jani “Leksikologji e gjuhës shqipe”, Tiranë: “Dudaj”, 2005.

### Letërsi e Gjuhes B (1)

Programi i lëndës	
<b>Lënda:</b>	Letërsi e Gjuhes B (1)
<b>Cikli:</b>	Bachelor
<b>Kursi:</b>	Viti II (Gjuhë angleze)
<b>Semestri:</b>	I (i parë)
<b>ECTS:</b>	4 Kredite - (= 40 orë);
<b>Nr. Leksioneve:</b>	2 Kredite - (= 20 orë);
<b>Nr. Seminareve:</b>	2 Kredite - (= 20 orë).
<b>Pedagogu/(ët) e lëndës:</b>	Dr. Esmeralda Subashi, Dr. Loran Gami, Msc. Blerina Zaimi

## PËRSHKRIMI I LËNDËS

Kjo lëndë synon të mbulojë në mënyrë kronologjike rrymat kryesore letrare dhe kulturore të Letërsisë Britanike, duke filluar me letërsinë e hershme britanike, duke vijuar me letërsinë e Mesjetës, atë elizabetiane, letërsinë e shekullit XVIII dhe duke përfunduar me letërsinë e periudhës së romantizmit. Ajo ka për qëllim njohjen e studentëve me këto rryma dhe drejtime kryesore letrare në Britaninë e Madhe, si dhe njohjen e tyre me autorët klasikë të letërsisë angleze, duke analizuar veprat e tyre më përfaqësuese.

### Objektivat e kursit:

Ky kurs synon:

- të prezantojë studentët me rrymat kryesore letrare dhe kulturore te Letërsisë Britanike, duke filluar me letërsinë e hershme dhe duke përfunduar me letërsinë e periudhës së Romantizmit.
- t’i njohë studentët me shkrimtarët kryesorë britanikë të këtyre periudhave dhe veprave të tyre më përfaqësuese.
- nëpërmjet leximit dhe diskutimit të veprave t’u krijojë studentëve një panoramë më të gjerë për kulturën dhe shoqërinë britanike, duke mbajtur parasysh se studimi i veprave letrare është një mënyrë mjaft e mirë për të kuptuar kulturën dhe shoqërinë e një vendi të huaj.
- t’i nxisë studentët që, veçanërisht gjatë seminareve, të mprehin mendimin e tyre kritik dhe individual. Vepra letrare, me poliseminë e saj, është e hapur ndaj



interpretimeve të ndryshme që mund të bëjnë studentët, të cilët nxiten që të shprehin mendimin e tyre të argumentuar.

- ta përmirësojë nivelin e tyre të përvetësimit të gjuhës dhe të zhvillojë të lexuarit kritik.

### **Rezultatet e pritshme:**

Në fund të kursit studentët:

- do të kenë një njohje të mirë të rrymave kryesore letrare dhe kulturore të Letërsisë Britanike, duke filluar me letërsinë e hershme dhe duke përfunduar me letërsinë e periudhës së Romantizmit.
- do të kenë një njohje të mirë të shkrimtarëve kryesorë britanikë të këtyre periudhave dhe të veprave të tyre më përfaqësuese.
- do të kenë një panoramë më të gjerë për kulturën dhe shoqërinë britanike.
- do të mprehin mendimin e tyre kritik dhe individual.
- do të përmirësojnë nivelin e tyre të përvetësimit të gjuhës
- do të jenë më të aftë për të analizuar një vepër letrare.

### **VLERËSIMI**

- 10 % pjesërrja dhe prezantimet individuale të studentëve gjatë seminareve (një prezantim)
- 10% eseja
- 30 % Provimi i mes-semestrit
- 50 % Provimi përfundimtar

### **LITERATURA E DETYRUESHME**

- Leksione të përgatitura nga titullari i lëndës
- *The Norton Anthology of English Literature*, M.H.Abrams, General Editor, New York: W.W.Norton & Company: 1996. (pp. 5-10, 65-70, 253-270, 819-837, 882-884, 1261-1273) (I disponueshëm në bibliotekën e Departamentit të Gjuhës Angleze)
- *The Norton Anthology of English Literature, Volume 1*, Fifth Edition, Editor M.H.Abrams, New York, London: W.W. Norton: 1986. (ff 1942-1943) (I disponueshëm në bibliotekën e Departamentit të Gjuhës Angleze)
- Emile Legouis, Louis Cazamian, *A History of English Literature*, Revised edition, London: J.M.Dent and Sons LTD. (ff 410-419) (I disponueshëm në bibliotekën e Fakultetit të Historisë dhe të Filologjisë, UT).
- *The Oxford History of English Literature IX: The Early 18th-century*, Editors Bonamy Dobree, John Buxton, Norman Davis, Oxford: Clarendon Press: 1990. (445-460) (I disponueshëm në bibliotekën e Departamentit të Gjuhës Angleze)
- *Encyclopaedia of Literature and Criticism*, editors Martin Coyle, Peter Garside, Malcolm Kelsall, John Peck, Detroit, New York: Routledge, 1991 (ff. 363-374). (I disponueshëm në bibliotekën e Departamentit të Gjuhës Angleze)
- *The Oxford History of English Literature – Chaucer and Fifteenth-Century Verse*, H.S.Bennett, Oxford: Clarendon Press: 1990 (ff 64-81) (I disponueshëm në bibliotekën e Departamentit të Gjuhës Angleze)

## Vepra letrare:

- Geoffrey Chaucer, *The Canterbury Tales*, (I disponueshëm online në <http://www.gutenberg.org/>)
- William Shakespeare, Sonnets. Në: *The Norton Anthology of English Literature*, M.H.Abrams, General Editor, New York: W.W.Norton & Company: 1996. (ff 469-481) (I disponueshëm në bibliotekën e Departamentit të Gjuhës Angleze)
- William Shakespeare, *The Merchant of Venice*, New Penguin: 1977. (I disponueshëm në bibliotekën e Departamentit të Gjuhës Angleze )
- William Shakespeare, *Hamlet*, (I disponueshëm online në <http://www.gutenberg.org/>)
- Jonathan Swift, *Gulliver's Travels*, (I disponueshëm online në <http://www.gutenberg.org/>)
- Daniel Defoe, *Robinson Crusoe*, Hertfordshire: Wordsworth Classics, 1994. (I disponueshëm në bibliotekën e Departamentit të Gjuhës Angleze) (Gjithashtu disponueshëm online në <http://www.gutenberg.org/>)
- *Oxford Anthology of English Literature: Romantic Poetry and Prose*, Harold Bloom, Lionel Trilling, New York: Oxford University Press: 1973. (592-611) (I disponueshëm në bibliotekën e Departamentit të Gjuhës Angleze).

## LITERATURA E REKOMANDUAR

- Andrew Sanders, *The Short Oxford History of English Literature*, Oxford: Clarendon Press, 1994. (I disponueshëm në bibliotekën e Departamentit të Gjuhës Angleze)

### Analizë teksti e Gjuhes B (3)

Programi i lëndës	
<b>Moduli:</b>	Analizë teksti e Gjuhes B (3)
<b>Cikli:</b>	i parë
<b>Fusha e formimit:</b>	Gjuhësi
<b>Kursi kurrikular:</b>	Gjuhë Angleze
<b>Kursi:</b>	II
<b>Viti/Semestri:</b>	2016-2017, semestri i parë
<b>ECTS:</b>	4
<b>Nr. Leksioneve:</b>	0
<b>Nr. Seminareve:</b>	40
<b>Pedagogu/(ët) e lëndës:</b>	Prof. Dr. Shpresa Qatipi, Prof.Asoc.Dr. Leonard Danglli, Dr. Miranda Veliaj, Dr. Ergys Bezhani, Dr. Rovena Vora, Dr. Kristina Ajazi, Dr. Blerina Zaimi, Dr. Vjollca Tabaku

## PËRSHKRIMI I MODULIT

Lënda “Analizë Teksti” synon të përmirësojë nivelin e përgjithshëm të gjuhës angleze të studentëve të vitit të dytë në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, Dega Anglisht. Përmes këtij kursi

studentët do të jenë në gjendje të zhvillojnë gjuhën dhe aftësitë për të arritur nivelin Advanced English, pra Nivelin C1.

Mësimdhënia do të përqendrohet në forcimin e aftësive të mëposhtme:

- të lexuarit,
- zgjerimi i fjalorit,
- përforcimi i njohurive gramatikore,
- përdorimi i duhur i gjuhës,
- përforcimi i aftësive për të shkruar në mënyrën e duhur
- përforcimi i shprehisë së dëgjimit

### **Objektivat e kursit**

Lënda do të jetë e fokusuar në përgatitjen e studenteve që të mësojnë të shkruajnë në mënyrë të rregullt dhe të përpiqen t'i transmetojnë sa më qartë mendimet e tyre nëpërmjet gjuhës angleze në nivelin C1. Gjatë orëve mësimore do të përdoren burime të ndryshme të cilat do të ndërthuren në mënyrë harmonike me nivelin akademik të studentëve, si dhe me lëndë të tjera.

Këto objektiva do të arrihen nëpërmjet seminareve, eseve, diskutimeve, prezantimeve, etj. Studentët do të arrijnë të shkruajnë detyra të ndryshme me standardet përkatëse që do të kenë gjatë viteve të shkollës së lartë dhe do të arrijnë t'i prezantojnë ato në mënyrë sa më të saktë. Të gjitha seancat mësimore do të jenë të orientuara drejt studentëve. Atyre do t'u kërkohet jo vetëm që të ndjekin mësimin por të jenë pjesë aktive e tij. Do të synohet që gjatë gjithë kohës së orës mësimore studentët t'i trajtojnë çështjet përmes të menduarit kritik.

### **Rezultatet e pritshme**

Studentët janë të gatshëm të përfundojnë me sukses Nivelin C1 të gjuhës. Të gjitha njohuritë e fituara do t'u shërbejnë studentëve gjatë ushtrimit të njohurive të tyre në jetën e përditshme për të bërë kërkime akademike dhe profesionale, për të analizuar tekste në gjuhën angleze, për të diskutuar për probleme të ndryshme, etj.

### **Metoda didaktike**

Gjatë zhvillimit të këtij kursi do të përdoren një sërë metodash dhe strategji të mësimdhënies të cilat synojnë rritjen e efikasitetit të procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Orët e mësimit do të kenë në qendër studentin dhe aktivizimi i tij do të realizohet edhe nëpërmjet punës në grup, në çift, apo zhvillimit të projekteve të përbashkëta. Synohet rritja e rolit ndërveprues të studentit nëpërmjet vlerësimit të njëri-tjetrit apo trajtimit të çështjeve të ndryshme në formën e diskutimit. Do të vihen gjithashtu në zbatim elemente të metodave analitike, përshkruese, krahasuese, etj.

### **VLERËSIMI**

- 20% detyra dhe testime gjatë semestrit
- 30% provimi në mes të semestrit
- 10% pjesëmarrja aktive në mësim
- 40% provimi përfundimtar

### **BIBLIOGRAFI E DETYRUESHME**

## BIBLIOGRAFI E REKOMANDUAR

Advanced Gold (Exam Maximiser): *Sally Burgess & Richard Acklam, Pearson Education Limited*, 2014.

### Gjuhë C (3)

Programi i lëndës	
<b>Moduli:</b>	Gjuhë C (3)
<b>Cikli:</b>	I pare
<b>Fusha e formimit</b>	
<b>Kursi kurrikular</b>	Bachelor
<b>Kursi:</b>	Viti i dytë
<b>Viti/Semestri:</b>	i pare
<b>ETCS:</b>	4 kredite
<b>Nr. Leksioneve:</b>	
<b>Nr. Seminareve:</b>	40 ore
<b>Pedagogu/(ët) e lëndës:</b>	

### PËRSHKRIMI I MODULIT

Kjo lënde synon t'u ofrojë studentëve një bazë njohurise të gjuhës angleze për ta përdorur atë si mjet komunikimi në jetën e përditshme dhe në ambiente të ndryshme ku mund të paraqitet nevoja e komunikimit me këtë gjuhë.

#### Objektivat e kursit:

Në fund të kursit studentët duhet të jenë në gjendje:

- Të pyesin dhe të përgjigjen në gjuhën angleze për tema të ndryshme të jetës së përditshme.
- Të komunikojnë me folës të tjerë të gjuhës angleze pa pasur probleme të të kuptuarit.
- Të diskutojnë për tema të ndryshme që ofrohen në libër por edhe nga vetë studentët.
- Të përdorin konceptet mbi mesatare të gjuhës angleze në dokumente zyrtare, në letra jozyrtare, në mesazhe elektronike dhe në histori të ndryshme.
- Të krijojnë dhe të shkruajnë histori duke përdorur fjalorin përkatës dhe të mëparshëm të marrë gjatë këtyre javëve mësimore.
- Të lexojnë dhe të kuptojnë një tekst te regjistrave te ndryshme dhe më pas të jenë të aftë ta përpunojnë atë.

#### Rezultatet e pritshme:

- Të bëjë të mundur komunikim sa më të lirshëm.
- Studentët të pajisen me njohuri mbi mesatare gramatikore.

- Të mundësojë pjesëmarrje të studentëve në diskutime të plota dhe gjithëpërfshirëse.
- Të ndihmojë studentët të shkruajnë dhe të lexojnë rrjedhshëm në gjuhën angleze.

### **Metoda didaktike**

Per realizim e kesaj lende do te perdoret libri i studentit dhe libri i ushtrimeve, detyra te ndryshme, prezantime dhe pune ne grupe.

### **VLERËSIMI**

- Test i ndërmjetëm 1 = 20%
- Test i ndërmjetëm 2 = 20%
- Pjesëmarrja (përfshin përgjigjet në klasë dhe detyrat me shkrim të kërkuara gjatë semestrit) = 30%
- Provimi përfundimtar = 30%

### **BIBLIOGRAFI E DETYRUESHME**

Harris M, Mower D, Sikorzysnka A. New Opportunities –Intermediate, Student’s book, Longman

Harris M, Mower D, Sikorzysnka A , New Opportunities Intermediate Language Powerbook, Longman

### **BIBLIOGRAFI E REKOMANDUAR**

Ky kurs bazohet në metodën e përmendur më lart, por studentëve do t’u kërkohet të këshillohen me libra, revista dhe internetin në mënyrë që të marrin njohuri shtesë mbi fushat dhe konceptet e dhëna në libër.

### **Histori e SHBA –së**

<b>Programi i Lëndës</b>	
<b>Moduli:</b>	Histori e SHBA –së
<b>Cikli:</b>	Bachelor
<b>Kursi:</b>	Viti II
<b>Semestri:</b>	II
<b>ECTS:</b>	4 Kredite -
<b>Numri i leksioneve:</b>	20 orë
<b>Nr i seminareve:</b>	20 orë
<b>Pedagogu/(ët) e lëndës:</b>	Prof Dr. Shpresa Qatipi, Dr. Rovena Vora, Dr. Ervin Hoxhaj, Dr. Ergys Bezhani

## **PERSHKRIMI I LENDES**

Ky kurs mundëson:

- Një prezantim gjithëpërfshirës të Historisë Amerikane
- Të kuptuarit e disa aspekteve kryesore të Historisë Amerikane
- Informacion të përditësuar të zhvillimeve në Amerikë
- Identifikimin dhe krahasimin e impaktit të kulturës, gjeografisë dhe ekonomisë si burime të ndryshimit dhe vazhdimësisë së Historisë Amerikane
- Përfundime në lidhje me rolin dhe kontributin e individëve, grupeve dhe institucioneve në Historinë e Amerikës.

Ky kurs ndahet në 9 periudha të rëndësishme historike:

1491 – 1607

1607 – 1754

1754 – 1800

1800 – 1848

1848 – 1877

1877 – 1914

1914 – 1945

1945 – 1989

1989 – të tashmen

### **Objektivat e kursit dhe rezultatet e pritshme:**

Në fund të kursit, studentët duhet të kenë përmbushur objektivat e mëposhtme:

- Të jenë në gjendje të kuptojnë zbulimin e Amerikës si dhe arsyet e zbulimit të saj
- Të njohin terminologjinë e rëndësishme nga Historia e Amerikës dhe të analizojë lidhjen e tyre me ngjarjet e rëndësishme historike
- Të jenë në gjendje të kuptojnë kolonitë e Amerikës dhe arsyet se pse ato mbijetuan dhe rrjedhimisht u bënë shtete
- Të jenë në gjendje të përshkruajnë zhvillimin historik të shteteve të Amerikës
- Të jenë në gjendje të kuptojnë arsyet se pse Amerikës iu desh të luftonte një luftë civile dhe se çfarë kuptimi kishte kjo luftë nga pikëpamja kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Të jenë në gjendje të kuptojnë lidhjet ndërkombëtare të Amerikës
- Të jenë në gjendje të kuptojnë sjelljet dhe qëndrimet shoqërore në Amerikën e sotme si rezultat i së shkuarës
- Të përdorin burime parësore dhe dytësore në planifikimin dhe komunikimin e informacioneve dhe ideve historike.

### **VLERESIMI I KURSIT**

- 20% detyra me shkrim (javët 3, 6, 9, 12)
- 30% provim në mes të semestrit (java e shtatë)
- 10% pjesmarrje aktive në klasë
- 40% provimi përfundimtar

### **BIBLIOGRAFI E DETYRUESHME**

“An outline of American history”

## BIBLIOGRAFI E REKOMANDUAR

- Theodore Sutro “Thirteen Chapters of American History”
- Edward Channing “A Short History of the United States”
- David Henry Montgomery “The Beginner’s American History”

### Analizë teksti e Gjuhës B (4)

Programi i lëndës	
<b>Moduli:</b>	Analizë teksti (B4)
<b>Cikli:</b>	i parë
<b>Fusha e formimit:</b>	Gjuhësi
<b>Kursi kurrikular:</b>	Gjuhë Angleze
<b>Kursi:</b>	II
<b>Viti/Semestri:</b>	2016-2017, semestri i dytë
<b>ECTS:</b>	4
<b>Nr. Leksioneve:</b>	0
<b>Nr. Seminareve:</b>	40
<b>Pedagogu/(ët) e lëndës:</b>	Prof. Dr. Shpresa Qatipi, Prof.Asoc.Dr. Leonard Danglli, Dr. Miranda Veliaj, Dr. Ergys Bezhani, Dr. Rovena Vora, Dr. Kristina Ajazi, Dr. Blerina Zaimi, Dr. Vjollca Tabaku

### PËRSHKRIMI I MODULIT

Lënda “Analizë Teksti” synon të përmirësojë nivelin e përgjithshëm të gjuhës angleze të studentëve të vitit të dytë në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, Dega Anglisht. Përmes këtij kursi studentët do të jenë në gjendje të zhvillojnë gjuhën dhe aftësitë për të arritur nivelin Advanced English, pra Nivelin C1.

Mësimdhënia do të përqendrohet në forcimin e aftësive të mëposhtme:

- të lexuarit,
- zgjerimi i fjalorit,
- përforcimi i njohurive gramatikore,
- përdorimi i duhur i gjuhës,
- përforcimi i aftësive për të shkruar në mënyrën e duhur
- përforcimi i shprehisë së dëgjimit

### Objektivat e kursit

Lënda do të jetë e fokusuar në përgatitjen e studenteve që të mësojnë të shkruajnë në mënyrë të rregullt dhe të përpiqen t’i transmetojnë sa më qartë mendimet e tyre nëpërmjet gjuhës angleze në nivelin C1. Gjatë orëve mësimore do të përdoren burime të ndryshme të cilat do të ndërthuren në mënyrë harmonike me nivelin akademik të studentëve, si dhe me lëndë të tjera.

Këto objektiva do të arrihen nëpërmjet seminareve, eseve, diskutimeve, prezantimeve, etj. Studentët do të arrijnë të shkruajnë detyra të ndryshme me standardet përkatëse që do të kenë

gjatë viteve të shkollës së lartë dhe do të arrijnë t'i prezantojnë ato në mënyrë sa më të saktë. Të gjitha seancat mësimore do të jenë të orientuara drejt studentëve. Atyre do t'u kërkohej jo vetëm që të ndjekin mësimin por të jenë pjesë aktive e tij. Do të synohet që gjatë gjithë kohës së orës mësimore studentët t'i trajtojnë çështjet përmes të menduarit kritik.

## Rezultatet e pritshme

Studentët janë të gatshëm të përfundojnë me sukses Nivelin C1 të gjuhës. Të gjitha njohuritë e fituara do t'u shërbejnë studentëve gjatë ushtrimit të njohurive të tyre në jetën e përditshme për të bërë kërkime akademike dhe profesionale, për të analizuar tekste në gjuhën angleze, për të diskutuar për probleme të ndryshme, etj.

## Metoda didaktike

Gjatë zhvillimit të këtij kursi do të përdoren një sërë metodash dhe strategji të mësimdhënies të cilat synojnë rritjen e efikasitetit të procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Orët e mësimi do të kenë në qendër studentin dhe aktivizimi i tij do të realizohet edhe nëpërmjet punës në grup, në çift, apo zhvillimit të projekteve të përbashkëta. Synohet rritja e rolit ndërveprues të studentit nëpërmjet vlerësimit të njëri-tjetrit apo trajtimit të çështjeve të ndryshme në formën e diskutimit. Do të vihen gjithashtu në zbatim elemente të metodave analitike, përshtetëse, krahasuese, etj.

## VLERËSIMI

- 20% detyra dhe testime gjatë semestrit
- 30% provimi në mes të semestrit
- 10% pjesëmarrja aktive në mësim
- 40% provimi përfundimtar

## BIBLIOGRAFI E DETYRUESHME

Advanced Gold (Coursebook): *Richard Acklam with Sally Burgess, Pearson Education Limited*, 2014.

## BIBLIOGRAFI E REKOMANDUAR

Advanced Gold (Exam Maximiser): *Sally Burgess & Richard Acklam, Pearson Education Limited*, 2014.

### Letërsi e Gjuhes B (2)

Programi i lëndës	
<b>Moduli:</b>	Letërsi e Gjuhes B (2)
<b>Cikli:</b>	Bachelor
<b>Fusha e formimit</b>	Letërsi
<b>Kursi kurrikular</b>	Gjuhë angleze
<b>Kursi:</b>	Viti III
<b>Viti/Semestri:</b>	III, i dytë
<b>ETCS:</b>	4 kredite - (= 40 orë);
<b>Nr. Leksioneve:</b>	2 kredite - (= 20 orë);
<b>Nr. Seminareve:</b>	2 kredite - (= 20 orë).



## PËRSHKRIMI I MODULIT

Ky kurs i njeh studentët me letërsinë moderne britanike, duke filluar me origjinën e modernizmit, me vitet e fundit të shekullit XIX deri në fund të Luftës së Dytë Botërore. Kursi ka si qëllim që t'i pajisë studentët me një vështrim të përgjithshëm rreth periudhave të sipërpërmendura në letërsinë britanike, duke ndjekur një qasje kronologjike. Në të njëjtën kohë, ky kurs synon që ta përmirësojë njohurinë që kanë studentët për tri zhanret kryesore të letërsisë, prozën, poezinë dhe dramën. Leksionet dhe seminarët ofrojnë një ndërthurje të njohurive teorike mbi tiparet kryesore të periudhave letrare që studiohen dhe të analizës së veprave të caktuara, të shkruara nga autorët më përfaqësues të këtyre periudhave.

### Objektivat e kursit:

Ky kurs ka si qëllim:

1. t'i njohë studentët me sfondin kulturor, historik dhe letrar të letërsisë moderniste
2. t'u ofrojë studentëve njohuri bazë mbi tiparet kryesore të prozës britanike moderniste
3. t'u ofrojë studentëve njohuri bazë mbi tiparet kryesore të poezisë moderniste britanike
4. t'u ofrojë studentëve njohuri bazë mbi tiparet kryesore të dramës moderniste britanike
5. t'i aftësojë studentët që ata të jenë në gjendje të kryejnë analiza të romaneve, tregimeve të shkurtra, poezive dhe dramave të përzgjedhura
6. t'i nxisë studentët që të përgatisin prezantime të shkurtra mbi autorë të ndryshëm që i përkasin këtyre periudhave letrare
7. ta pasurojë leksikun e studentëve dhe ta rrisë aftësinë e tyre për të punuar në mënyrë korrekte me terminologjinë e fushës përkatëse.

### Rezultatet e pritshme:

- studentët do të njihen me lëvizjet kryesore letrare dhe kulturore në periudhat letrare që studiohen,
- studentët do të njihen me shkrimtarët kryesorë britanikë të shekullit XX dhe me veprat e tyre më përfaqësuese,
- studentët do të kenë një njohuri më të mirë të kulturës dhe të shoqërisë britanike,
- studentët do t'i zhvillojnë më tej aftësitë e të menduarit kritik,
- studentët do ta përmirësojnë nivelin e tyre të njohjes së gjuhës angleze.

## VLERËSIMI

- Provimi gjysmëfinal: 30%
- Pjesëmarrja 10%
- Provimi përfundimtar 60%

## LITERATURA E DETYRUESHME

- Cikël leksionesh nga titullari i lëndës
- Çarls Dickens “Shpresa të mëdha”
- Xhosef Konrad “Zemra e errësirës”
- Oskar Uajld, “Portreti i Dorian Greit”/ “E rëndësishme është të quhesh Ernest”
- V.Ulf, “Njolla në mur”
- Xhejms Xhojs, “I vdekuri”
- T.S.Eliot “Këngë dashurie e Xh.A. Prufrokut”
- XH.B. Shou “Profesioni i Zj.Uoren”
- D.H.Lourens “Të dashur dhe bij”

## LITERATURA E REKOMANDUAR

- The Norton Anthology of English Literature, Volume 2: The Romantic Period through the
- Twentieth Century, eighth edition, M.H. Abrams, Stephen Greenblatt, W. W. Norton & Company 2006;
- Andrew Sanders, The Short Oxford History of English Literature, 2004;
- The Realist Novel, Dennis Walder, Routledge, 2001;
- Edmund Gosse, A short history of modern English literature, Cambridge University Press, 2011

### Stilistikë e Gjuhës B

Programi i lëndës	
<b>Lënda:</b>	Stilistikë e Gjuhës B
<b>Cikli:</b>	Bachelor
<b>Kursi:</b>	Viti II (Gjuhë angleze)
<b>Semestri:</b>	II (i Dytë)
<b>ECTS:</b>	4 Kredite - (= 40 orë);
<b>Nr. Leksioneve:</b>	2 Kredite - (= 20 orë);
<b>Nr. Seminareve:</b>	2 Kredite - (= 20 orë).
<b>Pedagogu/(ët) e lëndës:</b>	Prof.dr. Daniela Tamo, Dr. Adelina Albrahimi, Prof.Asoc.Dr. Adriana Dervishaj, Dr. Sidita Hoxhiq

### PËRSHKRIMI I LËNDËS

Lënda “Stilistikë e Gjuhës Angleze” është pjesë e programit trevjeçar bachelor të formimit të studentëve të gjuhës angleze në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja në Universitetin e Tiranës.

Programi realizohet përmes leksioneve, seminareve, ushtrimeve, prezantimeve, punës në grup dhe detyrave të kursit dhe provimit përfundimtar.

### Objektivat e kursit

Kjo lëndë synon të japë bazen teorike të Stilitikës, të ndihmojë studentët të fitojnë konceptet dhe shkathtësitë për të kuptuar dhe analizuar nga këndvështrimi gjuhësor dhe stilistikor pjesë të ndryshme, të shkruara apo të folura, të bëjnë krahasimin e materialeve të ndryshme, të studjojnë përdorimin e gjuhës dhe variacionin gjuhësor, të studjojnë zbatimin dhe përdorimin e gjuhës si mjet shprehës, të interpretojnë tekste nga fusha të ndryshme të jetes, kerkimit dhe shkences. Materialet e përzgjedhura janë të tilla që të mund të përdoren në klasë si dhe të mund të shfrytëzohen nga studentët në detyrat e tyre të shtëpisë apo detyrat e kursit. Kjo gjë i jep mundësi drejtuesit të kursit të mund të vlerësojë në mënyrë objektive dhe të vazhdueshme përgatitjen e studentëve dhe nivelin e njohurive të përfituara gjatë këtij kursi.

### Rezultatet e pritshme:

Në përfundim të kursit studentët do të jenë të aftë:

- të kuptojnë analizën stilistike të një teksti të caktuar
- të kryejnë analizën stilistike të një teksti të caktuar
- të bëjnë krahasime të mjeteve stilistikore të përdorura në tekste të natyrave të ndryshme
- të nxjerrin përfundime
- të përgatisin tekste për pasqyrimin e njohurive të marra;
- të jenë në gjendje të dallojë llojet e teksteve të ndryshme;
- të kuptojnë tiparet dalluese stilistikore të llojeve të ndryshme të teksteve;
- të jenë më analitikë, dhe të lexojnë përtej rreshtave.

### VLERËSIMI

Nota e studentit del nga përmbushja e kënaqshme e kërkesave të mësipërme, nga ecuria e studentit në zhvillimin e shkakthësive.

	<b>Rubrikat që vlerësohen</b>	<b>%</b>
	Frekuentimi	10%
	Testi në mes të semestrit, javen e shtatë	10%
	Kryerja e detyrimeve (detyrat çdo orë)	10%
	Dorëzimi i detyrës së kursit, java 12	10%
	Provimi final	60%
Totali		100%

### LITERATURA E DETYRUESHME

- Crystal D. & Dereck D. (1969): *Investigating English Style*, Longman, London.
- Lloshi Xh. (2001): *Stilistika e Gjuhës Shqipe dhe Pragmatika*, ShBLU, Tirana
- Simpson P. (2004): *Stylistics, a Resource Book for Students*, Routledge
- Verdonk, P. (2002): *Stylistics, Oxford Introductions to Language Study Series*, Oxford
- Wood, Nancy V. (2009): *Perspectives on Argument*, Pearson, Prentice Hall
- Fahnestock, J. & Secor, M. (2003): *A Rhetoric of Argument*, Mc Graw Hill

### LITERATURA E REKOMANDUAR

1. Hope, J., Wright, L. (1995): *Stylistics: a Practical Coursebook*,

2. Jeffries, L., McIntyre, D. (2010): *Stylistics* (Cambridge Textbooks in Linguistics)
3. Stockwell, P., Whiteley, S. (2014): *The Cambridge Handbook of Stylistics*, Cambridge Handbooks in Language and Linguistics
4. Thornborrow, J. & Warreing, Sh. (2005): *Patterns in Language, An Introduction to Language and Literary Style*, Routledge.
5. Itule, Bruce D., Anderson, Douglas A. (1993): *News Writing and Reporting for Today's Media*, Mc Graw Hill
6. The Missouri Group, (2013): *Telling the Story*, University of Missouri, Columbia
7. Wood, Nancy V. (2013): *Essentials of Argument*, Pearson Prentice Hall
8. Glenn, Ch. (2010): *Making Sense, a Real-World Rhetorical Reader*, Penn State University

### Variante të Gjuhës B

Programi i lëndës	
<b>Lënda:</b>	Variante të Gjuhës B
<b>Cikli:</b>	Bachelor
<b>Kursi:</b>	Viti II (Gjuhë angleze)
<b>Semestri:</b>	II (i dytë)
<b>ECTS:</b>	4 Kredite - (= 40 orë);
<b>Nr. Leksioneve:</b>	2 Kredite - (= 20 orë);
<b>Nr. Seminareve:</b>	2 Kredite - (= 20 orë).
<b>Pedagogu/(ët) e lëndës:</b>	Prof.dr. Daniela Tamo, Dr. Fatma Shijaku, Dr. Daniela Hasa, Msc. Anisa Agolli, Doktorante

#### PËRSHKRIMI I LËNDËS

Lënda “Variantet e Gjuhës Angleze” është pjesë e programit trevjeçar Bachelor të formimit të studentëve të gjuhës angleze në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja në Universitetin e Tiranës. Kjo lëndë synon trajtimin e njohurive bazë të variacionit gjuhësor të gjuhës angleze sipas fushave të ndryshme studimore të gjeografisë gjuhësore, sociolinguistikës, etj. dhe disiplinave gjuhësore të semantikës, fonetikës, gramatikës, etj. në një prerje kryesisht sinkronike duke trajtuar edhe disa të dhëna lidhur me zhvillimin diakronik të variacionit gjuhësor të gjuhës angleze dhe tipareve kulturore që lidhen me të.

Programi realizohet përmes leksioneve, seminareve, ushtrimeve, prezantimeve, testimeve, punës në grup dhe detyrave të kursit dhe provimit përfundimtar.

#### Objektivat e kursit:

Objektivat kryesore të kësaj lënde janë:

- t’u japë studentëve njohuritë kryesore në lidhje me variantet e gjuhës angleze dhe variancionin gjuhësor sipas teorive të gjeografisë gjuhësore, sociolinguistikës, etj. dhe sipas disiplinave të ndryshme gjuhësore, leksikore, sematike, gramatikore, fonetike, ortografike, etj.,
- të ndihmojë në aftësimin e studentëve për përdorimin e drejtë të varianteve të gjuhës angleze.

- t'u paraqesë dhe të nxisë tek studentët domosdoshmërinë e përdorimit të fjalorëve dhe teksteve të ndryshme sipas varianteve kryesore të gjuhës angleze për t'i përgatitur ata drejt një pune të pavarur në lidhje me zgjerimin dhe përvetësimin e gjuhës angleze sipas varianteve të shumta dhe variacionit gjuhësor.

### Rezultatet e pritshme:

Në fund të kursit studentët do të jenë të aftë të:

- kenë një njohje të mirë të variacionit gjuhësor dhe kulturor me të cilën lidhet zhvillimi dhe përdorimi i gjuhës angleze;
- kenë një njohje të mirë të ndryshimeve semantike, leksikore, gramatikore, fonetike dhe stilistikore midis anglishtes britanike dhe amerikane, si dhe të varianteve të tjera të gjuhës angleze;
- kenë një panoramë më të gjerë për kulturën dhe shoqërinë britanike dhe amerikane, australiane, etj. sipas dallimeve gjuhësore të trajtuara;
- përmirësojnë nivelin e tyre të përvetësimit të gjuhës në tërësinë e varianteve të gjuhës angleze;
- analizojnë tekste, pjesëza dëgjimore të ndryshme britanike, amerikane, etj. sipas veçorive gjuhësore.

### VLERËSIMI

Nota e studentit del nga përmbushja e kënaqshme e kërkesave të mësipërme, nga ecuria e studentit në zhvillimin e shkakthtësive.

	<b>Rubrikat që vlerësohen</b>	<b>%</b>
	Frekuentimi	10%
	Testi në mes të semestrit, javën e shtatë	10%
	Kryerja e detyrimeve (detyrat çdo orë)	10%
	Dorëzimi i detyrës së kursit, java 13	10%
	Provimi final	60%
Totali		100%

### LITERATURA E DETYRUESHME

- Baugh, Albert C. and Cable, Thomas. *A history of English language*, London: Routledge (1991).
- Jenkins, Jennifer *World Englishes*. Oxford: Oxford University Press (2000).
- Kovecses, Zoltan *American English (An Introduction)*, Peterborough, Canada: Boadview Press (2000).
- Trudgill, Peter and Hannah, Jean. *International English: Guide to Varieties of Standard English*, third ed. University of North London (1994).

### LITERATURA E REKOMANDUAR

- Hudson, Richard A. *Sociolinguistics*, Cambridge University Press (1996), (Botimi në shqip “Sociolinguistika” nga DITURIA 2004).
- Garret, Peter *Attitudes to language*, Cambridge University Press (2011)
- Tamo, D.: Punimi i disertacionit me temë: ”*Probleme të evoluimit të gjuhës angleze: varianti britanik dhe ai amerikan. Ndryshimet leksikore mes dy varianteve*”, Biblioteka Kombëtare (2007)
- Shijaku, F.: Punimi i disertacionit me temë “*Ndryshime fonetike, ortografike dhe gramatikore të anglishtes britanike dhe amerikane dhe strategjitë e njohjes dhe zbatimit të tyre në shkollën shqiptare*”, Biblioteka Kombëtare (2013)

### Gjuhe C (4)

Programi i lëndës	
<b>Moduli:</b>	Gjuhë C (4)
<b>Cikli:</b>	I pare
<b>Fusha e formimit</b>	
<b>Kursi kurrikular</b>	Bachelor
<b>Kursi:</b>	Viti i dytë
<b>Viti/Semestri:</b>	i dytë
<b>ETCS:</b>	4 kredite
<b>Nr. Leksioneve:</b>	
<b>Nr. Seminareve:</b>	40 ore
<b>Pedagogu/(ët) e lëndës:</b>	

### PËRSHKRIMI I MODULIT

Kjo lënde synon t’u ofrojë studentëve një bazë njohurise të gjuhës angleze për ta përdorur atë si mjet komunikimi në jetën e përditshme dhe në ambiente të ndryshme ku mund të paraqitet nevoja e komunikimit me këtë gjuhë.

#### Objektivat e kursit:

Në fund të kursit studentët duhet të jenë në gjendje:

- Të pyesin dhe të përgjigjen në gjuhën angleze për tema të ndryshme të jetës së përditshme.
- Të komunikojnë me folës të tjerë të gjuhës angleze pa pasur probleme të të kuptuarit.
- Të diskutojnë për tema të ndryshme që ofrohen në libër por edhe nga vetë studentët.
- Të përdorin konceptet mbi mesatare të gjuhës angleze në dokumente zyrtare, në letra jozyrtare, në mesazhe elektronike dhe në histori të ndryshme.
- Të krijojnë dhe të shkruajnë histori duke përdorur fjalorin përkatës dhe të mëparshëm të marrë gjatë këtyre javëve mësimore.
- Të lexojnë dhe të kuptojnë një tekst te regjistrave te ndryshme dhe më pas të jenë të aftë ta përpunojnë atë.

#### Rezultatet e pritshme:

- Të bëjë të mundur komunikim sa më të lirshëm.
- Studentët të pajisen me njohuri mbi mesatare gramatikore.
- Të mundësojë pjesëmarrje të studentëve në diskutime të plota dhe gjithëpërfshirëse.
- Të ndihmojë studentët të shkruajnë dhe të lexojnë rrjedhshëm në gjuhën angleze.

### Metoda didaktike

Per realizim e kesaj lende do te perdoret libri i studentit dhe libri i ushtrimeve, detyra te ndryshme, prezantime dhe pune ne grupe.

### VLERËSIMI

- Test i ndërmjetëm 1 = 20%
- Test i ndërmjetëm 2 = 20%
- Pjesëmarrja (përfshin përgjigjet në klasë dhe detyrat me shkrim të kërkuara gjatë semestrit) = 30%
- Provimi përfundimtar = 30%

### BIBLIOGRAFI E DETYRUESHME

Harris M, Mower D, Sikorzysnka A. New Opportunities Intermediate, Student's book, Longman

Harris M, Mower D, Sikorzysnka A , New Opportunities Intermediate Language Powerbook, Longman

### BIBLIOGRAFI E REKOMANDUAR

Ky kurs bazohet në metodën e përmendur më lart, por studentëve do t'u kërkohet të këshillohen me libra, revista dhe internetin në mënyrë që të marrin njohuri shtesë mbi fushat dhe konceptet e dhëna në libër.

### Marrëdhënie publike

Programi i lëndës	
<b>Moduli:</b>	<b>Marrëdhënie Publike</b>
<b>Cikli:</b>	Kurrikula në Cikli I-Viti II
<b>Fusha e formimit</b>	Gjuhe angleze
<b>Kursi kurrikular</b>	Bachelor
<b>Kursi:</b>	I
<b>Viti/Semestri:</b>	2016 – 2017/ I/II
<b>ETCS:</b>	Kredite = 4 , 40 ore
<b>Nr. Leksioneve:</b>	

<b>Nr. Seminareve:</b>	40 orë
<b>Pedagogu/(ët) e lëndës:</b>	Dr. Miranda Veliaj, Dr. Jonida Petro, Dr. Rozana Bela, MSc.Ermal Çomo, Doktorant, MSc.Anisa Agolli, Doktorante

## **PËRSHKRIMI I LËNDËS**

Kjo lende synon qe te pajise studentin me informacion të përgjithshëm të proceseve, praktikave dhe efekteve të marrëdhënieve publike si një nga fushat kryesore në zhanrin e komunikimit por edhe si një drejtim kariere për studentët. Ajo ofron mundësi për të zhvilluar dhe kuptuar mënyrat me të cilat marrëdhëniet publike zhvillohen dhe ndikojnë në një sërë fushash të tjera që kanë lidhje me ekonominë, jetën sociale dhe politike të një vendi. Lënda shtrihet në semestrin e I-re ose te II-te të ciklit të pare të studimeve dhe është një ndër disiplinat me zgjedhje që u frohen studentëve të viti të dytë. Në këtë lëndë alternohen njohuritë teorike me ato praktike ku perparesi do te kete zbatuesmeria e njohurive ne apsektin praktik. Parashikon detyra ne forme projekti të ndryshme të realizuara nga studentët në grup ose individualisht dhe qe duhet te paraqiten ne klase. Disa nga ceshtjet qe trajtohen perfshijne njohuri tëpërgjithsme mbi Marrëdhëniet Publike (MP-PR); funksionimi në praktikë; rrahja e mendimeve dhe të menduarit në mënyrë krijuese; përgatitja e strategjive dhe planeve të veprimit; zbatimi i strategjive të MP, zotërimi i audiencës, dominimi i tregut, etj.

### **Objektivat e kursit:**

Ky kurs synon te ndihmoje studentet:

- të përvetësojnë proceset e të menduarit kritik që kanë të bëjnë me zgjidhjen e problemeve organizative dhe marrjen e vendimeve në situata dhe kushte të ndryshme.
- për t'u përqndruar në drejtim të marrëdhënieve publike si një karrierë e mirrëfilltë dhe ofron mundësi të zhvillojnë dhe kuptojnë mënyrat me të cilat vendimet e marrëdhënieve publike ndikojnë në një sërë profesione të tjera.
- të njihen dhe eksplorojnë disa prej problemeve me të cilat ndeshen praktikuesit e marrëdhënieve publike në ditët e sotme, brenda një mjedisi gjithnjë e më shumë global, teknologjik dhe ku ndërthurren kultura dhe tradita të shumta.

### **Rezultatet e pritshme:**

Ne fund te kursit synohet qe studentet te kene perftuar njohuri baze mbi proceset, praktikat dhe efektet e marrëdhënieve publike për të zhvilluar dhe kuptuar mënyrat me të cilat vendimet e marrëdhënieve publike ndikojnë në jetën e përditshme për praktikuesit e fushës por edhe në një sërë profesione të tjera.

### **Metoda didaktike:**

Metodat didaktike që do të përdoren janë seminarët, prezantimet, diskutimet në grup si dhe ushtrimet e ndryshme që do të realizohen për të qartësuar problematikat.

## **VLERËSIMI**

Për vlerësimin përfundimtar merret parasysh prezenca, aktivizimi dhe rezultati i studentëve gjatë seminareve si edhe detyra e kursit/projekti e cila do të prezantohet para klases në ditën e



paracaktuar për prezantim. Detyra e cila duhet të prezantohet në klasë me programin *poëer point*, duhet të përmbajë një hyrje, një zhvillim dhe një përfundim. Koha në dispozicion të çdo studenti/grupi nuk duhet të kalojë 10 minuta. Studentët janë të detyruar të frekuentojnë kursin në përputhje me rregulloren e fakultetit. Për të vlerësuar studentët do të përdoren tre metoda:

Vlerësimi do të kryhet në përputhje me tri drejtimet organizative të lëndës:

- 20% e vlerësimit përfundimtar do të varet nga frekuentimi dhe pjesëmarrja,
- 20% nga detyra praktike gjatë semestrit
- 60% rezultati i provimit në fund të semestrit.

## LITERATURA E DETYRUESHME

1. *Eric Yaverbaum and Bob BLY, (2001) Public Relation Kit for Dummies.* Wiley Publishing Inc.

## LITERATURA E REKOMANDUAR

1. Raste studimore nga media e shkruar dhe elektronike.
2. <http://www.prheadquarters.com/files/cepp.html>
3. <http://www.cision.com/us/resources/public-relations/>
4. [http://www.orps.state.ny.us/assessor/resources/pubrelations/guidelines\\_reporters.htm](http://www.orps.state.ny.us/assessor/resources/pubrelations/guidelines_reporters.htm)
5. [http://www.cerias.purdue.edu/about/public\\_relations](http://www.cerias.purdue.edu/about/public_relations)

### Anglishte e biznesit

Programi i lëndës	
<b>Moduli:</b>	Anglishte e biznesit
<b>Cikli:</b>	Bachelor
<b>Fusha e formimit</b>	Gjuhe angleze
<b>Kursi:</b>	Viti II D (i dytë)
<b>Viti/Semestri:</b>	I (i parë)
<b>ECTS:</b>	4 Kredite - (= 40 orë);
<b>Nr. Leksioneve:</b>	0
<b>Nr. Seminareve:</b>	4 Kredite - (= 40 orë).
<b>Pedagogu/(ët) e lëndës:</b>	Prof. Asoc.Dr. Adriana Dervishaj, Dr. Kristina Sheperi, Dr. Kristina Ajazi, MA. Luella Liçi, Doktorante

## PËRSHKRIMI I MODULIT

### Objektivat e kursit:

Kursi synon të nxisë interesin në fushën e biznesit dhe të ndihmojë në përvetësimin e disa prej koncepteve të terminologjisë baze të biznesit në gjuhën angleze dhe për të motivuar një gamë të gjërë të studentëve në situata biznesi apo kur ata vihen në marrëdhënie pune. Në të njëjtën kohë synohet forcimi i shprehive gjuhësore dhe zgjerimi i fjalorit në situata të tilla si negociata, prezantime, nëpërmjet përdorimit të rasteve studimore që bazohen në skenarë të vërteta nga bota e biznesit.

Materialet e përzgjedhura janë të tilla që të mund të përdoren në klase si dhe të mund të shfrytëzohen nga studentet në detyrat e tyre të shtëpisë apo ato jashtë klase. Kjo i jep mundësi drejtuesit të kursit të vlerësojë në mënyrë objektive dhe të vazhdueshme përgatitjen e studenteve dhe nivelin e njohurive të përfituara gjatë këtij kursi.

### **Rezultatet e pritshme:**

- të ndihmojë studentët të pëmirsojnë fjalorin e tyre në fushën e biznesit;
- të zhvillojnë gjuhën që nevojitet për zhvillimin e aftësive të rëndësishme të komunikimit në fushën e biznesit;
- të ndihmojë në përvetësimin e disa prej koncepteve të terminologjisë baze të biznesit;
- të forcojë përdorimin e shprehive gjuhësore në situata të caktuara

**Metoda didaktike:** Seminare

### **VLERËSIMI**

- Provimi gjysmëfinal: 20%
- Projekt: 30%
- Frekuentimi dhe pjesëmarrja 10%
- Provimi përfundimtar 40%

### **BIBLIOGRAFI E DETYRUESHME**

Market Leader, 3rd edition, David Cotton, David Falvey, Simon Kent, Pearson Education, 2010

### **BIBLIOGRAFI E REKOMANDUAR**

Intelligent Business, Tonnya Trappe, Graham Tullis, Pearson Education, 2008

### **Shprehi komunikimi**

<b>Programi i lëndës</b>	
<b>Lënda:</b>	Shprehi komunikimi
<b>Cikli:</b>	I parë
<b>Kursi:</b>	Viti III (Gjuhë angleze)
<b>Semestri:</b>	I (i parë)
<b>ECTS:</b>	4 Kredite - (= 40 orë);
<b>Nr. Leksioneve:</b>	2 Kredite - (= 20 orë);
<b>Nr. Seminareve:</b>	2 Kredit - (= 20 orë).
<b>Pedagogu/(ët) e lëndës:</b>	Dr. Albana Çoni, Dr. Rudina Vrioni

### **PËRSHKRIMI I LËNDËS**

Studimet në shkencën e komunikimit i njohin studentët me strategji, ide, koncepte dhe aftësi, si dhe me njohuri mbi kontekste të ndryshme të komunikimit njerëzor. Përveç të nxënimit të modeleve dhe teorive të ndryshme të komunikimit, studentët njihen me teoritë kryesore të komunikimit ndërpersonal, komunikimit në grup dhe të folurit publik. Ata gjithashtu

stimulohen të rrisin nivelin e aftësive dhe kompetencës në komunikim duke qenë pjesë aktive e diskutimeve në grup, në aktivitete ndërpersonale dhe duke prezantuar fjalime informuese dhe ndikuese.

Kursi fillon me një vështrim të modeleve kryesore të komunikimit për të vazhduar me studimin e elementeve kryesore të teorisë së komunikimit dhe studimit të teorive mbi prodhimin dhe përforcimin e kulturës përmes komunikimit.

Qëllimi i kursit është që studentët të marrin njohuri të mjaftueshme teorike dhe praktike mbi komunikimin si shkencë e aplikuar.

Këndvështrimi gjuhësor i programit të lëndës Shprehi Komunikimi, i ofron studentëve hyrje në çështjet teorike që lidhen me përkufizimin dhe këndvështrimet që egzistojnë për komunikimin në shoqëri, vendin që zë midis shkencave të tjera dhe pikëprerjet midis tyre. Ky program u ofron studentëve mundësinë të studiojnë edhe veçoritë e komunikimit gjuhësor dhe praktik.

### **Objektivat e kursit:**

Lënda Shprehi Komunikimi synon që studentët të përfitojnë elementët bazë të hyrjes në teorinë e komunikimit. Në përfundim të kursit studentët duhet të kenë njohuri të mjaftueshme e përjasjet kryesore teorike në shkencën e komunikimit si dhe njohuri mbi modelet dhe konceptet më të rëndësishme në këtë fushë. Në fund të kursit studentet do të jenë të aftë të përkufizojnë komunikimin dhe rëndësinë e tij, të përkufizojnë karakteristikat e komunikimit, parimet bazë të tij si dhe t'i përcaktojnë dhe analizojnë ato në tri kontekstet bazë të komunikimit përkatësisht në atë ndërpersonal, grup dhe të të folurit publik.

### **Rezultatet e pritshme:**

Në fund të kursit studentët që arrijnë të plotësojnë kushtet dhe detyrimet e kursit, do të jenë të aftë të vlerësojnë teorinë e komunikimit në mënyrë efektive, t'i zbatojnë ato në jetën e tyre të përditshme si dhe në një numër kontekstesh të ndryshme, veçanërisht në atë ndërpersonal dhe familiar. Studentët do të jenë të aftë të përballen me studime dhe kërkime sistematike në fushën e komunikimit. Ata do të përmirësojnë aftësitë e tyre për të analizuar dhe sintetizuar materiale në këtë fushë.

## **VLERËSIMI**

### **Procedurat në klasë**

Në klasë do të përdoren disa metoda, përfshi leksionin, diskutiminin formal të studentëve dhe ushtrime formale. Këto ushtrime kanë qëllim të testojnë dhe provojnë konceptet e ngritura në diskutime dhe leksione si dhe të stimulojnë mendimin mbi konceptet e teorisë së komunikimit. Studentët kanë liri të plotë të ngrenë pyetje mbi materialet e konsultuara në klasë apo tekstet e lexuara mbi tematikën përkatëse.

### **Provimet, projektet dhe vlerësimi**

Vlerësimi përfundimtar do të jetë rezultat i vlerësimeve të marra kryesisht nga provimi përfundimtar që përbën 50% të tij. Testimet gjatëvitit, kontrollet e pjesëshme dhe pjesëmarrja aktive në kurs përbëjnë 35% të vlerësimit përfundimtar dhe 5% i takon mungesave. Programi mund të jetë objekt ndryshimi në përputhje me arritjet dhe pritshmëritë e studentëve.

## LITERATURA E DETYRUESHME

*An Introduction to Human Communication; Understanding and Sharing*, seventh edition, by Judy Pearson & Paul Nelson

## LITERATURA E REKOMANDUAR

1. *Communication Principles for a lifetime*, Steven A. Beebe, Suzan J. Beebe, DianaK Ivy; Allyn and Bacon
2. *Human communication- 4-th edition*, J. Pearson, P. Nelson, S. Titsworth, L. Harter

### Letërsi Amerikane 1

Programi i lëndës	
<b>Moduli:</b>	Letërsi Amerikane 1
<b>Cikli:</b>	Bachelor
<b>Fusha e formimit</b>	Letrare
<b>Kursi kurrikular</b>	Gjuhë Angleze
<b>Kursi:</b>	III
<b>Viti/Semestri:</b>	Viti III/1
<b>ECTS:</b>	4 kredite
<b>Nr. Leksioneve:</b>	20
<b>Nr. Seminareve:</b>	20
<b>Pedagogu/(ët) e lëndës:</b>	Prof. Dr. Maks Daiu, Brunilda Kondi

### PËRSHKRIMI I LËNDËS

Letërsia amerikane 1 zhvillohet në semestrin e dytë të vitit të dytë dhe përmban katër kredite. Lënda zhvillohet në gjuhën angleze.

#### Objektivat e kursit:

Lënda synon t'i njohë studentët me lëvizjet, periudhat dhe autorët kryesorë të letërsisë amerikane nga fillimet e saj deri sot. Ajo i mbulon të tria gjinitë, prozën, poezinë dhe dramën, duke u përqendruar veçanërisht në zhvillimin e tyre gjatë shekujve XIX dhe XX. Tekstet letrare vendosen në kontekstin e gjerë shoqëror dhe historik të kohës së tyre dhe konceptohen si shfaqje të rëndësishme të kulturës së tyre.

#### Rezultatet e pritshme:

Në përfundimin e lëndës studentët do të njohin:

- tiparet e romantizmit dhe realizmit amerikan në të tria gjinitë letrare; poezi; prozë dhe dramë;
- disa nga përfaqësuesit kryesorë të të tria gjinive,
- nga një vepër përfaqësuese të autorëve kryesorë.

**Shënim:** Çdo student do të dorëzojë një detyrë kursi.

### **VLERËSIMI**

- Provimi gjysmëfinal: 20%
- Projekt: 30%
- Frekuentimi dhe pjesëmarrja 10%
- Provimi përfundimtar 40%

### **BIBLIOGRAFI E DETYRUESHME**

- Daiu, Maks, *American Literature: Beginnings to Naturalism* (New Edition), Albas, Tiranë, 2015.
- Daiu, Maks, *Modern American Literature* (New Edition), Albas, Tiranë, 2015.
- Daiu, Maks, *Contemporary American Literature*, Albas, Tiranë, 2014.
- Daiu, Maks, “*Profile prozatorësh modernë amerikanë*”, Shtëpia Botuese e Librit Universitar, Tiranë, 2000.

### **BIBLIOGRAFI E REKOMANDUAR**

- Bayam, Nina et al. eds., *The Norton Anthology of American Literature*, 4<sup>th</sup> ed., 2 vols., W.W. Norton & Company, New York, 1994.
- Daiu, Maks, “*Studime mbi romanin bashkëkohor amerikan*”, Shtëpia Botuese e Librit Universitar, Tiranë, 1997.

## **Përkthim 1**

<b>Programi i lëndës</b>	
<b>Lënda:</b>	Përkthim 1
<b>Cikli:</b>	Bachelor
<b>Kursi:</b>	Viti III (Gjuhë angleze dhe Studime Britanike e Amerikane)
<b>Semestri:</b>	I (i parë)
<b>ECTS:</b>	4 Kredite - (= 40 orë);
<b>Nr. Leksioneve:</b>	1.5 Kredite - (= 15 orë);
<b>Nr. Seminareve:</b>	2.5 Kredite - (= 25 orë).
<b>Pedagogu/(ët) e lëndës:</b>	Prof.Dr. Viktor Ristani, Dr. Iris Klosi, Dr. Orges Selmani, M.Sc. Nejla Qafmolla, Doktorante, M.Sc. Ermal Çomo, Doktorant

### **PËRSHKRIMI I LËNDËS**

Lënda “Përkthim 1” për studentët e Vitit III, Gjuhë angleze dhe Studime Britanike e Amerikane, duke e trajtuar gjuhën si sistem, duke trajtuar përkthimin si proces dhe si produkt, si dhe duke ndërthurur zbërthimin, interpretimin dhe qasjen e tekstit, jo vetëm në nivelin mikro, por edhe në nivelin makro, do t’u shërbejë studentëve të mund të strukturojnë dhe të përcjellin në gjuhën shqipe dhe anasjelltas efekte të barasvlefshme, ose të përafërta, në atë masë që lejojnë mjetet gjuhësore shprehëse të shqipes e anglishtes, si dhe faktorë të tjerë gjuhësorë e jashtgjuhësorë.

Nëpërmjet materialit gjuhësor problemor autentik, në përputhje me nivelin e njohurive të përftuara gjatë dy viteve të para, të përzgjedhur me kujdes nga literatura angleze dhe amerikane e të gjitha zhanreve, stileve e regjistrave, si të gjuhës së shkruar dhe asaj të folur, do të mundësohet përfshirja dhe ndërthurja e përkthimit me Studimet Britanike dhe Amerikane, në mënyrë që studentët të njihen jo vetëm me gjuhën por edhe me jetën, kulturë, qytetërimin, institucionet, etj. në vëndet anglishtfolëse.

### **Objektivat e kursit:**

- trajtimi në plan praktik dhe teorik të dukurive gramatikore, leksikore dhe stilistike të gjuhëve anglisht dhe shqip.
- krijimi i lidhjes organike ndërmjet lëndëve të ndryshme dhe përkthimit në aspektin praktik dhe aplikativ në këndvështrimin e marrëdhënies shumëdisiplinore dhe ndërdisiplinore;
